

Aleksandër Bojaxhi
Mjeshtër i Edukimit

ARGËTOME

NË

NATYRË

Shtëpia Botuese TOENA

PASQYRA E LËNDËS

1. Përkushtim
2. Malet dhe njerëzit
- Ndër vite
- Patriarku, Tatëmadhi i Alpinizmit
- Mali i Tomorit
- Berati dhe Mali i Tomorit
3. Alpinizëm
- Lindja
- Ekipi i parë Shqiptar në Malin e Bardhë
- Kur filloi alpinizmi në Shqipëri
- Veçori të sportit të Alpinizmit
- Si realizohet një ngjitje Alpinistike
- Fushimi
- Vlerësime
4. Jo Alpinizëm
- Kacavarja
- Harcimi
- Bjeshkimi
- Rancat
- Gara malore
5. Shtojca
- 11 Dhjetori
- Mali i Dajtit në Vjeshtë
- Batina historike në ngjitjen e maleve
- Prindër, mundësoni fëmijët që të shkojnë atje ku është natyra
- Lehtizat në natyrë për familjarë
- Të kujdesurit për Natyrën

P Ë R K U S H T I M

Mbas vitit 2003, tek vija hera herës në Shqipëri, mësoja nga shokë të qyteteve të ndryshme edhe të rejat rreth sportit tim të parapëlqyer, alpinizmit. Ata më shprehnin e më përcillnin ndjesi e mendime të ndryshme, por në një pikë ata bashkoheshin tek më thonin atë që nuk më pëlqente ta dëgjoja: “Nuk ka më alpinizëm! Ka kohë që ka ikur ajo kohë...”

Ky realitet më shtyu, që krahas formave të tjera që duhen ndjekur për ta ringjallur alpinizmin, të nxjerr në dritë këtë libër për këdo, shumë bazik në lëndë, të parin e një serie me botime për sportin e alpinizmit, ku do të përfshihen aventura të arritjeve botërore, kujtime personale dhe njohuri të karakterit teoriko-mësimor.

Në faqet që do të lexoni, do keni rastin të mësoni çfarë është e çfarë nuk është alpinizëm. Megjithatë, theksoj, ky botim nuk i takon vetëm alpinistëve: **ky botim është për cilindo lexues që dëshiron të njohë dhe pasurojë kulturën e tij, për disa nga sportet dhe format argëtuese të kalimit të kohës së lirë në natyrë.**

Serinë e botimeve ua përkushtoj të rinjve, me bindjen që ata që do të joshen nga alpinizmi dhe format e tjera të argëtimit në natyrë, do i shtojnë vlera shëndetit të tyre mendor e fizik.

Autori

MALET DHE NJERËZIT

Ndër vite

Kur ka filluar njeriu të ngjitë për të parën herë malet? Kjo nuk dihet dhe sigurisht, meqë qytetërimi ka filluar para se njerëzit të dokumentonin çdo lloj ngjarje, as kurrë nuk do të mësohet. Gjetjet flasin për Europjanë të ngjitur në Alpet e Evropës, mbi 5.000 vjet më parë, të paktën deri në lartësinë 3,000 metra. Gjithashtu nga dokumentimet ma të herëshme, si dhe nga gjetjet arkeologjike, mësojmë se shekuj më parë, popujt që jetonin në Andet e Amerikës Jugore ngjiteshin në maja 5-6000 metra të larta dhe aty ndiznin zjarre të mëdha e kryenin rite të ndryshme besimi.

Në temat mësimore rreth botës antike, ne kemi mësuar se grekët e lashtë e konsideronin malin e Olimpiti si mal të shenjtë dhe se në majë të tij, kishin vendosur me mëndjet e tyre fronet e 12 perëndive, me në krye Zeusin. Por jo vetëm grekët e lashtë, por në përgjithësi për banorët e zonave malore, majat e maleve përfaqësonin banesën e shënjtëruar të zotave e jo të njerëzve të zakonshëm, andaj dhe sundon mendimi për aborigenët, (vendasit e dorës së parë) se ata nuk kanë kryer ngjitje në maja malesh.

Kërkime jo të largëta, në Kordilieriet e Amerikës Jugore dëshmojnë rezultate të mahnitëshme, madje që mundet të merren edhe si rezultate të pastra sportive, të arritura nga një numur i madh i ngjitesve malorë të shekujve të shkuar të shtyrë nga qëllime magjike e rituale pak të kuptueshme. Pa asnjë pajisje dhe pa përgatitje të veçantë grupe të tëra njerëzish pa pushim kaluan shkëmbej e akuj, përballuan të ftohtë e tufane, duke u ngjitur në lartësi gati shtatë mijë metroshe, kur evropianët vetëm në shekullin e 18-të pushtuan majën më të lartë të qendrës së kontinentit, Mont Blanc (4.810 m).

Kronikat e epokës së pushtuesve spanjollë, bëjnë fjalë për therore të kryera prej inkasve në lartësi të maleve. Këtyre njoftimeve për Eldoradon e përtej reve dikur pak kush u besonte.

Porse, në fund të shekullit të 19-të, zbuluesit mundën të binden me sytë e tyre, se në ato kronika ka pjesë të së verëtetës. Gjetjet a zbulimet e para u bënë në kreshtat që rrethojnë shkretëtirën Atakoma. Rajoni shtrihet nga Peruja Jugore e deri thuajse në Santiago, duke përfshirë edhe një pjesë të territorit të Bolivisë e të Argjentinës. Një varg vullkanesh të shuar shtrihen gjatë kufijve Kili-Bolivi dhe Kili-Argjentinë dhe këtu malet janë me lartësi mbi 6.000 metra. Kujtojmë se kufiri i borës (d.m.th. i borës që nuk shkrin gjatë gjithë vitit) është 5.500 metra ose edhe ma poshtë. Pra, pjesa e sipërme e majave është gjithnjë me borë të ngrirë, ose akull. Luginat poshtë majave janë të gjelbëruara e të mundëshme për kullota. Sot ka njerëz, të cilët të parët e banorëve vendas (inkasve) *dëshirojnë* t'i quajnë “alpinistët e parë të botës.”

Gjatë viteve 1881-1889 shkencëtari Kilian Françisko San Roman u ngjit disa herë në majat 4000 e 5000 metroshe të Atakamës. Për habinë e tij, ai vuri re pranë majave mbeturina të ndërtimeve prej guri, si dhe lidhëse shkarpash të llojit, që ende i përdornin vendasit. Këto ishin shenja bindëse që tregonin se dikur aty ka patur njerëz. Porse, raporti i tij për zbulimet, i botuar në librin “Shkretëtirat dhe malet e Atakamës (Santiago 1896) nuk tërhoqën në masën e duhur vemendjen e specialistëve.

Pasi kaluan disa, vite udhëtari Uilliam Martin Konvej për rrugëtimin nga Peruja në Bolivi shkruajti: “Zoti Vagner, i cili punonte në gërmimet e Kajllomit, më tregoi për një dokument të vjetër, i cili ruhej tek pronari i minierës që nga koha e Konkistadorëve Shekulli 16). Në këtë dorëshkrim të vjetër përforcohet se Maja Çaçani (6.087 metra e lartë) ka shërbyer për inkasit si vend varrimi. Vetë Z. Vagner, pas një sërë përpjekjesh të pasuksesëshme, më së fundi u ngjit në majë, bashkë me një grup puntorësh vendas dhe kreu gërmime. Me keqardhje atij iu desh të bindej, se aty kishte qenë dikush para tij dhe i kishte boshatisur tërësisht varret (U.M. Konvej, *Andet Bolioiviane*, Londër 1901, faqet 56, 57).

Pas kësaj, interesi për “alpinizmin” para evropjan u rrit. Gjatë shekullit të kaluar dhjetra ekspedita arkelologjiko-alpinistike u janë drejtuar Andeve. Ato si rregull janë kthyer me “gjah” sensacional. Ja disa nga surprizat të sjella më poshtë në mënyrë thujse kronologjike.

Maja Çukulloi (5.420 m). Shkencëtari Francisko San Roman, gjeti në toren e majës një thikë bakri të llojit, me të cilën vendasit e përdornin kur bënë blatime (fli-jime).

Maja Likankabur (5.930 m). Më 1884, gjeologu Kilian Sevego Titiçoka, malësor vendas, u ngjit i vetëm në këtë vullkan dhe u ndesh me një vendosje të renditur gurrësh dhe drushë zjarri. Pas dy vjetësh ai rrishtaz u ngjit në majë me policin Hose Santeliceso. Të dy ngjitësit, kur arritën në majë, mblodhën të gjitha shkarpat dhe drutë e lëna aty nga vendasit (kush e di se sa?) vite ma parë dhe ndezën një zjarr. Tymi e zjarri u bënë dëshmi bindëse për banorët e luginës, për qënien e tyre në majë. Sipas fjalëve të ngjitësve në zjarr u kaluan tre ton dru(!). Sendet e gjetura aty prej tyre, u mblodhën dhe iu dorëzuan zotërve të rajonit dhe këta ia kaluan Muzeut të Historisë së Natyrës në Santiago. (Ndoshta ja vlen të ndalemi me kujdes në fjalinë: **Sendet e gjetura aty prej tyre u mblodhën dhe ju dorëzuan zyrtarëve të rajonit dhe këta ia kaluan Muzeut të Historisë së Natyrës në Santiago**). Këto zbulime përshkruhen në botimin e Luis Risapotroni-t “Kufiri Kilo-Bolivia”, faqe 108.

Në vitin 1955 ekspedita e inxhinjerit amerikan Uilliam Rudolf e pushtoi rishtaz majën Likankabur. Në kraterin e majës, ngjitësit vunë re diçka të veçantë, apo fenomen tepër të rrallë: liqen me ujë që nuk ngrin. Liqeni ka diametër 100 metra e thellësia arrin deri më 3 metra. Jo larg liqenit, lartësoshin gërmadhat e diçkaje që dukej si tre kasolle apo strehime prej guri. Sipërfaqja e seicilës kasolle, ishte rreth 10 metra katrore. Mënyra e vendosjes së gurëve nga vendasit quhet “nirka”, e ato ishin copa shkëmbi të ngjeshur njeri mbi tjetrin, kurse plasat mbylleshin me material të thërmueshëm. Përqark dergjeshin degëza e trarë. Ky “fshatëz” i çuditëshëm, të linte përshtypjen e një fshati të grabitur tërësisht. Raporti “Mbi të fshehtat e vullkanit të shuar” u botuan po atë vit në revistën e njujorkeze “Geographical Cronicle”.

Maja Sarasora (5.959 m). Në të u ngjit malësori vendas Benito Supanta. Në këtë vullkan ka disa maja e njera prej tyre doli e shënuar me një murëz guri. Pas 20 vjetësh, Supanta u ngjit edhe një herë, në majë në rolin e shoqëruesit të ekspeditës alpinistike peruane, të drejtuar nga Dionisio Sallas Vitangurt. Pak nën krater alpinistët rastësisht vunë re një pllakë prej argjenti të bakëruar që dukej sheshit se ishte prodhim inkas. Raportet mbi reliket e Sarasoras, u shkruan në librin “Përshkrimi i provincës Parinakoças”, Lima, 1950; f. 610-626.

Maja Pllomo (5.630 m). Maja ka një kupolë bore e ngrihet tej në periferi të Santjagos. Ajo i është nënshtruar një grabitje më të vogël, krahasuar me majat e tjera. Kjo, ndoshta ngaqë ngjitësit janë trembur nga bora e shkëmbejtë, që të presin rrugën drejt majës. Më 1922 u bë e kjartë se në brinjën J-P të lirë nga akujt, thujse bash nën majë, mundet të dallohen “piriket” indiane. Por vetëm më 1954 grupi i shoqëruesve malorë vendas arriti taracat e nënmajës dhe bëri gërmime. Rezultati i kaloi edhe shpresat e më të guximëshmeve. Së pari, u bë e mundur të

gjendet mumja e një të riu 20 vjeçar inkas të mbuluar me statujza ari, amuleta (send që mbahej në trup nga njeriu besimtar e që konsiderohej me veti magjike kundër sëmundjeve, fatkesqësive) diadema të çmueshme dhe byzylykë. Trupi i balsamosur, nga pamja, duket i një të riu të shquar e të sjellë për fli Zotit. Ai ka ndenjur shtrirë në mes të akujve shekullorë, për më shumë se njëmijë vjet. Mumja dhe sendet e vyera sot gjenden në Muzeun Kilien të Historisë së Natyrës, kurse maja Pllomo është pagëzuar “Maja e Thesarit”. Faktikisht, bumi alpino-arkeologjik në malet e Amerikës Jugore filloi, pikërisht pas kësaj gjetje të pandodhur më parë.

Maja Salla (5.036 m). Sigurisht, që inkët janë ngjitur në këtë mal me shumë procesione. Duke predikuar një fe të lidhur me yjet, ata e konsideronin detyrë të tyre afrimin drejt yjeve. Në majat e mprehta digjeshin dru në zjarre të mëdha, silleshin për theror njerëz e kafshë; priftërinjtë paganë kryenin vëzhgime astronomike. Për këtë u ndërtuan jo vetëm alltare dhe “observatorë”, por sipër drejt majës ngjiteshin rrugë të vërteta. Mbeturina të rrugëve të tilla, gjenden madje edhe deri në majën më të lartë të Sallës. Këto përshkrime i dha Luis Risapotroni në “Fjalorin Gjeografik i Kilit” (Santiago 1924, f. 790).

Maja Llullojlloko (6.723 m). Në vitin 1952, Bion Gonzales dhe Huan Harsejm u ngjitën “për herë të parë” në këtë majë dhe nuk u besonin syve të tyre: dikush, shumë kohë më parë, kish mbuluar atje një mur me penjë, e veç kësaj kish harruar aty çantën prej lëkure(!). Pas kësaj, maja u ngjit jo një herë nga ekspedita të tjera dhe sejcila prej tyre u ul poshtë me trofe: kush statujza, kush copa tjegulle, kush thikë. Ndërtime prej guri u panë në shpatet veriore e lindore të majës. Porse zbulimi më interesant i ra në pjesë Matias Rebiç dhe Narciso Diasas, të cilët në muajt Mars e Prill 1961, gërmuan një shtëpi të tërë me tre dhoma e me sipërfaqe 25 metra katrore e me mure me lartësi mbi tre metra. Në majën anësore të malit, ata pastruan nga bora një platformë me gurë të sheshtë. Në mes të platformës qëndronte alltari dhe pranë tij ndodheshin hyrjet për llamat. E përse llamat?... Mundet, që ato t’i sillnin për theror..., por mundet, që edhe të jenë shfrytëzuar si kafshë barre për të mbartur aty sendet e nevojshme për ritualet e zhvilluara, si dhe të thesareve që varrosnin. Ndërtesa tredhomëshe bashkohej me platformën me një rrugë guri e formës shkallare. Sipas mendimit të Rebiç, maja më shpesh se kurrë ka qenë vizituar në shk. XV, jo shumë kohë para lundrimit zbulues të Kristofor Kolombit. (Revista Alpinistike Amerikane, v. 1962, ff. 267, 268).

Maja Donja Anna (5.690 m) është e pasur me rrënoja prej guri, si dhe një “depo” drush. Kjo majë studjohet për vlera arkeologjike, veçanërisht gjatë mesit të viteve 50-të.

Maja de la Tortollas (6.323 m) ka gjithashtu shumë ndërtime (rënoja) prej guri.

Maja Antofalla (6.440 m). Pika ma e lartë ka një alltar rrethor me diametër 6 metra e me tre kollona në mes. Pak ma poshtë, në shpatin perëndimor, ka shumë shkarpa. Duket qartë se në kohën e ceremonive të shënjta në altar ndiznin zjarr gjigand, e kështu mali dukej si një vullkan në veprim.

Maja Koniano (6.072 m) ka rënime të gurta, mure e platformë.

Maja Gallan (5.650 m). Matias Rebiç gjeti këtu ndërtime prej guri dhe bëri gërmime. Gjahu i tij u mbyll me një sasi të madhe sendesh të bronxëta, të argjenda e të arta të inkasve. Më e vlefshme u konsiderua një statujë e argjendë e llamës.

Maja Toro (6.386 m). Më vitin 1964 në këtë majë, teknikisht të vështirë, në brinjën lindore, u ngjitën argjentinastit E. Groç dhe A. Beorçia. Mu në majë, ata panë të ngrirë një skelet njeriu, i cili ishte i mbuluar me copa shkëmbi. Rruazat e qafës së tij ishin të dërmuara si prej një goditjeje shumë të fortë nga pas.

Alpinistët e gërmuan shtresën gurore të majës dhe para tyre u shfaq një pamje e rrallë: trupi i një të riu të ruajtur shumë mirë(!). Ishte pajisur shumë mirë për jetën e varrit me gjithfarë sendesh. Pas Pllomos, kjo është gjetja e dytë e një varrosje të pagrabitur të epokës së inkasve. Ekspozitët e gjetur në Torro, ndodhen në muzeun krahinor të provincës Mendoza.

Alltarët, rrënojat, statujat, eshtra të vdekurish, gjurmë zjarresh etj., janë zbuluar edhe në maja të tjera, si: Mason (5.490 m), Bonete (5.658 m), Tebenkinço (5.790 m) Arakar (6.080 m), etj. Raportet për gjetjet janë botuar rregullisht në revistat alpinistike, meqë ekspeditat që ndërmerren për ngjitjen e majave janë të karakterit alpinistik, ose alpinistiko-arkeologjik.

Shkencëtarët, prej kohe i kanë varur shpresat për gjetje më të shumta në majën më të lartë Akonkagua (6.960 m). Në gjuhën e inkasve, *Akonkagua* d.m.th. *roja e bardhë*. Autorit të këtyre rrjeshtave, ndonëse i ka rënë rasti të lexojë për organizim ekspeditash alpinistiko-arkeologjike deri në vitin 2005, por jo gjithshka, nuk i ka rastisur të lexojë për zbulime në këtë majë. Rregulli i gjetjeve rezultoi të jetë: sa më e lartë maja, aq më të mëdha janë nderimet (gjetjet sot) e inkasve. Akonkagua është majë në territorin ku kanë jetuar inkasit. Fakti që më 1950 në shalën midis majës kryesore, e asaj në pjesën Veri-Perëndimore të majës, u gjetën mbeturinat e ngrira të llamës flet jo pak: për të arritur deri aty, kafsha e vetme është e pamundur. Me siguri, që ajo është sjellë deri aty, ose e ngarkuar ose për flijim nga vendasit.

Majat e larta të Amerikës Jugore janë shembulli që flet se *shumë kohë më parë ka patur edhe njerëz të guximshëm, që e kanë mposhtur tundimin për tu ngjitur në maja të larta të maleve*, duke ju përgjigjur thirrjes joshëse të seicilës prej tyre: “Eja! Ja ku jam!”

(Botimi: Pobjezhdenije Vershinij, v. 1968-1969; Sputnik Sovetskovo Alpinizma, ff. 122-129; Izdatelstvo “Misl”, Moskva, 1972; Autori V. Skurllatov).

Bota sportive, ndonëse nga shkrime të ndryshme për sa ma sipër, flitet me gjuhën e “alpinizmit paraevriopian”, nuk i ka njohur ngjitjet në majat e Andeve si ngjitje alpinistike. Dhe kjo edhe pse, lartësitë e majave të ngjitura janë të konsiderueshme dhe në disa prej atyre itinerari i ngjitjes nuk është i thjeshtë. ***Ato kanë qenë ngjitje të shtyra nga motive besimi e jo argëtimi, andaj dhe nuk kanë zënë vend në historinë e botës sportive.***

Patriarku, Tatëmadhi i Alpinizmit

Letra dërguar Dionisio da Borgo-s nga Francesco Petrarka më 1336.

Francesco Petrarca, filozof, poet dhe udhëtar, ka pas lindur më 20 Korrik 1304 në Arezzo. Më 1312 familja e tij u vendos në Carpentras, pranë Avignon. Ai është konsideruar një nga Humanistët e parë, pararendës i epokës së Rilindjes dhe bashkë me Dante Alighieri-n dhe Giovanni Boccaccio-n konsiderohet një klasik i literaturës ‘Trecento.’

Sot, unë realizova ngjitjen e malit më të lartë në këtë regjion, i cili është emërtuar në mënyrë të gabuar Ventosum (ERA në Latinisht). Motivi im i vetëm, ishte dëshira për të parë se çfarë të ofron një lartësi kaq e madhe.

Ekspeditën e kam patur në mendje për shumë vite; ngase sikundër e dini, unë kam jetuar në këtë regjion që nga fëmijëria, i hedhur këtu nga fati, që përcakton veprimtaritë e njeriut. Për pasojë mali, i cili është në dukje nga një largësi e madhe, ka qenë gjithnjë para syve të mi dhe unë isha ai, që ngiza planin për të bërë atë që arrita sot.

Partnerët

Kur fillova të shikoj për një bashkëudhëtar, kuptova me habi të madhe se, ishte shumë e vështirë të gjeja një të përshtatëshëm midis shokëve të mi. Është shumë e rrallë që të takojmë përputhjen më të mirë të shijeve dhe karakteristikave që kemi, madje edhe midis atyre që janë më të dashurit me ne. (...) Të tilla mangësi, megjithse me peshë/madhore, mundet të jenë të lindura dhe miqësia pranon çfardo bare; porse është krejt ndryshe në një udhëtim, ku çdo dobësi a mangësi bëhet shumë më e rëndësishme.

Megjithate zgjidhja ishte përkrah meje: a mundet ta besoni? Unë iu ktheva familjes për ndihmë dhe ja propozova ngjitjen vëllait tim të vetëm, i cili është më i ri se unë, e me të cilin ju njiheni mirë. Ai u mrekullua dhe ndjeu kënaqësi nga mendimi që do të ishte me mua në vendin e vëllait dhe bashkëudhëtarit njëherësh.

Ngjitja

Në orën e menduar lamë shtëpinë dhe në mbrëmje arritëm në Malaucene, i cili shtrihet në rrëzë/këmbë të malit, në anën veriore. Pasi pushuam këtu një ditë, ne përfundimisht realizuam ngjitjen këtë mëngjes, duke patur si shoqërues askënd tjetër, veç dy shërbëtorëve dhe po u them se ishte një detyrë e vështirë. Mali është mjaft i thepisur dhe thuajse një masë shkëmbore e pashteg, porse ashtu sikundër e ka thënë poeti aq mirë “Puna ngulmuese dhe e pandalë arrin gjithshka.” Ishte një ditë e gjatë dhe me qiell të mrekullueshëm. Ne ju kënaqëm furisë se mendjes dhe forcës e zhdërvjellësisë së trupit. Rrugës ndeshëm një bari të moshuar në një nga luginat e malit, i cili u përpoq, mandej ngulmoi, të na kthejë mëndjen, duke na treguar se diku pesëdhjetë vite ma parë, ai me të njejtin zjarr rinor, sikundër edhe ne, pati arritur majën, por u shpërblye për mundimin e tij me asgjë tjetër, veçse me lodhje e pendim, si dhe veshjet e trupi të shqyera nga shkëmbejtë dhe gjëmbart e trëndafilave të egër apo shkurret. Askush deri më sot, për aq sa ai apo shokët e tij dinë, nuk ka tentuar të ngjitet para apo pas tij. Porse, këshillat e tij më shumë e rritën se sa e dobësuan dëshirën tonë për të vazhduar, ngaqë rinia është mosbesuese ndaj këshillave.

Ndërsa vëllai im zgjodhi, një shteg i cili të nxirrte drejt e në kreshtë, unë me plogështi zgjodha një më të thjeshtë i cili në të vërtetë ulej. Kur më thirri vëllai dhe më tregoi shtegun e duhur, unë iu përgjigja se shpresoja të gjeja shteg ma të mirë nga ana tjetër dhe nuk do të pyesja nëse do shkoja edhe ma larg; mjaftonte që të gjeja shteg më pak të pjerrët. Ky ishte thjesht një justifikim për plogështinë time. Kur të tjerët (vëllai e shërbëtorët) arritën një lartësi të konsiderueshme, unë ende vërdallisesha në luginë. Kisha dështuar në gjetjen e një shtegu më të thjeshtë dhe kisha shtuar largësinë e vështirësinë për ngjitjen. Përfundimisht ndjeva neveri për mënyrën e komplikuar që kisha zgjedhur dhe vendosa të kryej ngjitjen pa u ndjerë/zhurmë. Kur e arrita vëllanë, i cili ndërsa priti për mua pati mjaft kohë që të pushojë, isha i lodhur dhe i irrituar (...). Është e tepërt të them, se nga irritimi im dhe për habinë e vëllait tim, unë bëra po këtë gabim të njejtë edhe tre herë të tjera brënda disa orësh.

Mbi retë

Përfundimisht ne arritëm një majë të malit, atë më të lartën nga të gjitha. Në majë kishte pak vend të sheshtë porse aty ne mundëm të pushojmë trupat tanë të lodhur. Fillimisht, për shkak të cilësisë së veçantë të ajrit dhe ndikimit të pamjes së gjërë që më hapej para syve, unë qëndrova si një i shushatur/maramendur. Shikoja retë nën këmbët tona.

Ky filozof bjeshkatar në letrën e tij, më tej, shpjegon se kishte në dorë një botim të Shën Agustinit, “Rrëfimet”, një nga librat, që për përmbajtjen ndikonte fuqishëm në mendimet e tij. Duke e hapur aty, ku e zuri dora ai lexoi: “Dhe njeriu jepet për tu mrekulluar në lartësitë e maleve, dhe me valët e fuqishme të detit, dhe me përmbytjet e lumejve, dhe nga rrethi oqeanor, dhe nga rrotullimi i yjeve, por nuk e konsideron vehten.”

Petrarka kurrë nuk iu ngjit ndonjë mali tjetër në jetën e tij. Pamvarsisht nga kjo ai ishte bërë ndoshta “tatëzot-i i alpinizmit” shekuj para se aristokratët Francezë, Anglezë, etj., zbuluan kënaqësinë e ngjitjes së maleve si sport.

Dy fjalë për malin: Mali Mons Ventosum, sigurisht është ende aty ka ka qënë! Sot e quajnë Mont Ventoux (mali i erës në Frëngjisht). Është pika më e lartë e Provence-s, në Francën Jug-Lindore, me lartësi 1912 metra. I shtrirë pranë Carpentras-it, ai dallon nga malet e tjera dhe ndeshet nga ndikime të rëndësishme klimatike: ndryshime të mëdha të temperaturës që shkojnë nga valë ajrore të nxehta në -30 gradë Celcius. Gjatë stinës së verës, dita e zhegut mundet të pasohet nga dita e borës. Era mundet të arrijë 250 km/h dhe fryn nga të gjitha drejtimet.

Majat e malit ofrojnë pamjet më të gjëra të Francës: nga largësitë e tokave Italiane, në Mesdheun e kaltër, në Alpet Rhone dhe në ditët e kthjellta, tek majat e masivit të Mont Blanc-ut (Malit të Bardhë). Është një vend i shquar natyral me një varietet të gjërë/madh llojesh vegjetare dhe kafshësh. UNESCO e ka klasifikuar “Réserve de Biosphère.”

Ngjitja në faqen veriore të malit, nga ana Malaucène është 21 km e gjatë dhe ka një ndryshim në disnivel (qëndër banimi – majë) prej 1.535 m. Një rrugë me thërmaqe e bitum me një mesatare pjerrësie prej 7,3% (10% në disa pjesë) e ka bërë malin Mont Ventoux një nga ‘kalimet ngjitëse’ më të famëshme për çiklistat.

Bota alpinistike nuk e rregjistron ngjitjen e patriarkut si ngjitje alpinistike, e as ditën e ngjitjes së majës, që ai kreu si ditëlindje të alpinizmit, megjithse në literaturën alpinistike ai me raste etiketohet si “tatëzot i alpinizmit.” Patriku, vërtet u ngjit në majë të malit për argëtim, për kënaqësi, por *ai është një rast i veçantë dhe jo pjesë e ndonjë rryme të shoqërisë së asaj kohe, që e shikonte malin e ngjitjen në të të shtyrë nga motive argëtuese apo kënaqësive të mëdha.*

Burimi. Francesco Petrarca: The first Modern Scholar and Man of Letters (New York: G.P. Putnam, 1898).

Mali i Tomorit

Po sjell dy fragmente nga botimi i autorit Robert Elsie: A Dictionary of Albanian Religion, Mythology, and Folk Culture (Botimi në shqip: Leksiku i kulturës popullore Shqiptare; besime, mitologji, fe, doke, rite, festa dhe veçori kulturore; Shtëpia botuese Skënderbeg Books, 2005).

Tomor, Mali. Vend i shenjtë dhe gojzhanë. Tomori – Τόμαρος, është një vargmal në krahinat e Beratit e të Skraparit, ku hyn edhe, në pjesën veriore të vargmalit, maja më e lartë e Shqipërisë Qendrore, me lartësinë 2.416 metra. Në besimet popullore shqiptare, Mali Tomor del si vend ku banojnë perënditë. Mali, është personifikuar vetë si perëndi: Baba Tomori. Fshatarët e këtyre krahinave, bëjnë be për Baba Tomorin, be që quhet më e fortë se betë për Biblën a për Kuranin. Shumë banorë të këtyre krahinave, nga nderimi ose nga ndroja, kur duan të përmendin këtë mal, e thonë me eufemizëm, thjesht “ai”, dhe bëjnë be “për atë çukë.” Malin Tomor e kanë të shenjtë si të krishterët, të cilët venë atje më 15 Gusht, Ditën e të Ngriturit të Zonjës në Qiell (për nder të Shën Mërisë), ashtu edhe bektashinjtë, të cilët i falen Abaz Aliut gjatë peligrinazhit vjetor më 20-25 të Gushtit.

Në gojzhanat, figura e Baba Tomorit përfytyrohet si një plak me mjekër të gjatë e të lëshuar, që i zbret deri në brez. Përqark, i qëndrojnë në ajër katër shqiponja femra sqep gjatë, të

cilat ulen në shpatet e mbuluara me borë. Sipas Maximilian Lambertz-it (1882-1963), ai ka ardhur, e ka mbetur deri në ditët tona, nga një perëndi e lashtë Ilire. Ja thelbi i kësaj gojdhane:

Baba Tomori ka marrë për nuse të Bukurën e Dheut. Ajo e kalon ditën me të motrën, të Bukurën e Detit, por kur vjen mbrëmja, era, shërbyesja besnike e Baba Tomorit, e kthen prapë dhe ia shpie atij në mal. Mali Tomor ka poshtë qytetin e Beratit, të cilin ai e ruan me zili si qytetin më të dashur. Matanë luginës është Mali Shpirag, i çarë vija-vija, që i zbresin ujrat teposhtë me rrëmbim. Një ditë, kur Baba Tomori ende po flinte me të Bukurën e Dheut, Shpiragu përfitoi nga rasti dhe zbriti dhe e pushtoi Beratin. Katër shqiponjat roje e njoftuan menjëherë Baba Tomorin. Kur ia treguan planet tizare të Shpiragut, Baba Tomori u ngrit nga shtrati. Shqetësimin e parë e pati për të Bukurën e Dheut, andaj dhe i dha urdhër Erës që ta kthente atë e ta shpinte tek shtëpia e motrës së saj. Pastaj, hipi në një mushkë dhe u nis për tu përleshur me Shpiragun. Me kosën e tij, Tomori iu vërsul Shpiragut dhe i hapi shumë plagë, të cilat sot shihen në formën e vijave e brazdave, që i zbresin Malit të Shpiragut teposhtë. Thuhet, se një gjurmë e thundrës së mushkës së Baba Tomorit, mundet të shihet afër fshatit Sinjë. Shpiragu, nga ana e tij, e goditi fort Tomorin me topuz dhe i la shumë plagë malit të lartë, por u mund. Të dy gjigandët në fund e vranë njëri tjetrin dhe e Bukura e Dheut u mbyt në lot, nga të cilët u krijua lumi Osum.

Burimet: P. Ikonimi 1936; M. Hasluck 1939b, 1943; M. Lambertz 1937, ff. 504-505; P. Basha 1994; M. Tirta 1996a; J. Bullo 1997; M. Krasniqi 1997, ff. 206-207.

Abaz Aliu. Njeri i shenjtë musliman. Abaz Aliu, arabisht ‘*Ali Abdas*, gjendet i varrosur në një tyrbe, në majën jugore të Malit të Tomorit, (2.396 metra) ku shkojnë e falen pelegrinët. [Varri është hapur dhe kontrolluar më 1967 nga disa të rinj Beratas. Në të nuk u gjet asnjë eshtë. Shënim i autorit]. Tyrbja e tij, e ngritur më 1620, më pas u bë vend pelegrinazhi i Bektashijve, e duke qenë kështu, disa qindra metra sipër teqes bektashie të atjeshme, e cila u ndërtua më 1916, dhe aktualisht drejtohet nga Baba Shabani. Ky vend vizitohet nga besimtarët për vit, më 20-25 Gusht, kohë kur blatohet (therren bagëti).

Sipas një gojdhane, Abaz Aliu mendohet se ka qenë gjysmë vëllai i Hasanit e Huseinit, dhe ka ardhur nga Arabia, hipur mbi një kalë të bardhë për të shpëtuar vendin nga barbarët. Mendohet, se ka ndenjur pesë ditë në Malin e Tomorit, para se të shkonte për të jetuar në Malin e Olimpiti. Ai kthehet në Tomor për vit dhe rri aty pesë ditë, prandaj bëhet edhe peligrinazhi pesë ditor i Gushtit.

Poeti ynë i madh i Rilindjes Kombëtare, bektashi, Naim Frashëri (1846-1900) e përmend këtë njeri të shenjtë në një vjershë: “Abaz Aliu zu Tomorrë / Erdhi afër nesh / Shqipëria s’mbet e gjorë / Se Zoti desh” (*Lulet e Verës*, 1890).

Një gojdhane tjetër bektashiane thotë se Haxhi Bektashi, kur pa se pelegrinët të krishterë i ngjiteshin Malit të Tomorit më 15 Gusht, Dita e të Ngjiturit të Zonjës në Qiell, vajti deri në Qerbela të Irakut për të nxjerrë e për të marrë një eshtë krahu nga varri i Abaz Aliut, e pastaj e hodhi mbi majën e Tomorit për ta shënjtëruar këtë mal si varr të dytë të Abaz Aliut. Emri Abaz Ali, në legjendën e krishterë, njehësohet me Shën Ilian, dhe sot e kësaj dite dëgjohet në lutjet e banorëve vendës në shprehjen “Baba Abaz!”

Burimet: F. U. Hasluk 1929 f. 23; J. Sëire 1937, ff. 251-253; M. Hasluk 1939b; O Myderrizi, 1957 ff. 191-198; N. clayer 1990, ff. 164, 409-411; M. Tirta 1996b; J. Bullo 1997.

Berati dhe mali i Tomorit sipas Elvia Çelebiut

Elvia Çelebiu, ishte një udhëtar me emër i kohës së Perandorisë Osmane, i cili pati rastin dhe fatin të udhëtojë në Azi, Evropë e Afrikë dhe të na lërë shënime të vyera për jetën, në vendet ku shkeli, në shekullin e XVII-të. Ai, është cilësuar si një autor i madh në rangun e Herodotit, Ibni Batutit, Marko Polos, etj. La një vepër, e cila u përmbledh në 10 volume, e që sot i gjen të ribotura në 5.000 faqe.

Elvia Çelebiu udhëtoi edhe nëpër vise të etnisë shqiptare dhe ndër të tjera vizitoi dy herë Beratin rreth viteve 1672-1673. Më poshtë po paraqes shënimet e tij për këtë qytet të sjella në gjuhën shqipe nga i ndjeri Dr. Vasfi Samimi (Visoka) në botimin “Berati 300 vjet më parë.”

Rreth qytetit të Beratit gjenden gjithsej 77 vende dëfrimi dhe shëtitore. Së pari, gjenden në kalanë e sipërme, në shkëmbejtë Çel Beni, ku egzistojnë shumë vila e qoshe të bukura, pastaj poshtë, në sofat e tregut të tabakhanës dhe në tregun e ri të veshur me pyje të vegjël; po kështu, në malin e Tomorit, ku të rinjtë shkojnë edhe për gjueti. Mali i Thatë shërben si shëtitore, është një vend i gjelbër, i lulëzuar dhe i hijshëm; u ngjet atyre shëtitoreve, që gjenden në qytetin Korija dhe Mallatina (*shënim A.B.: janë qytete në Turqi*). Ka shumë burime ku rrjedhin ujra të pastërta jetëdhënëse. Janë të veshura me pemë të mëdha, nën hijen e të cilave, në sofat dhe në bankat e ndërnuara rreth e rrotull pemëve, mund të pushojnë me qindra njerëz.

Në Varoshin e thatë (*shënim A.B.: sot Goricë*) nuk ka hane e hamame, egzistojnë vetëm dy kisha të të krishterëve. Është një lagje përtej ujit, ku shtëpitë janë rradhitur në buzë të ujit, kanë dajlane dhe janë të mbajtura mirë. Lumi i Osumit kur fryhet në Berat, i përmbyt shtëpitë, tabakhanën dhe një sërë qoshesh, kafenetë dhe dyqanet e rrobaqepësve.

Qyteti i Beratit është i bukur, i mbajtur shumë mirë; të gjitha shtëpitë e parive të vendit (hanedanëve) fasadën e kanë të kthyer nga lumi, disa herë edhe imaretet mbeten nën ujë, por nuk pësojnë ndonjë dëm, sepse janë godina të forta dhe janë të mëdha.

Në jug të qytetit, dy orë larg, gjendet mali i Tomorit, që është i lartë, i madh e madhështor, aq sa duket nga distanca [të tilla] që janë gjashtë ditë larg. Bimët dhe gjuetia, që egzistojnë në këtë mal, janë të shumta, saqë shumë të huaj, dijetarë, mjekë venecianë, latinë prej këtyre vendeve, çdo vit hipin mbi këtë mal të madh dhe mbledhin lloj lloj bimësh mjekësore, duke i ngarkuar në mijëra kuaj. Në këtë mal ka shumë burime të freskëta, të cilat rrjedhin dhe shpërndahen rreth e rrotull në të katër anët, në 11 krahina.

Në malin e lartë gjenden shumë lloj kafshësh, insektesh e mizash që mund të konstatohen vetëm në malet e Bistonit, në malin e Sanxhakut, në malin e Demavendit, në Malin e Zi, në malin Agrimë, në malin Bin Gjoll, në malin e Elbrusit. Shkurtimisht, Tomori është një mal i lartë, i madh për të shëtitur (turizëm) dhe i përshtatshëm për gjueti.

Qyteti i Beratit është një vend bjeshkor, me ajër e ujë të pastër, ka shumë djem e vajza të shëndetshëm; ka njerëz të edukuar dhe të përmbajtur; të gjithë janë të bukur, të shkëlqyer dhe në përgjithësi janë të dhënë pas kënaqësive.

Burimi: Dr. Vasfi Samimi (Visoka), “BERATI 300 vjet më parë”, Botimet ‘Drita 2000’, Tiranë 2007.

Tek lexoj këtë përkthim dhe mësoj për jetën e pasur argëtore në këtë qytet, natyrshëm më lind pyetja: A ngjiteshin të rinjtë beratas të asaj kohe, deri në majë të Malit të Tomorit? Përgjigje të dokumentuar nuk kemi.

Ka mjaft male në botë, që konsiderohen nga popuj të ndryshëm, si male të shenjtë, ashtu sikundër Mali i Tomorit, Mali i Olimpët, Andet. Në to dhe në male të tjerë sigurisht që ka patur guximtarë që janë ngjitur, ashtu sikundër na e dëshmojnë në mënyrë të pakundërshtueshme gjetjet në majat e Andeve, në Amerikën Jugore. Porse, ndër shekuj malet kanë patur edhe hijen e frikës për banorët rreth tyre. Për shumë njerëz, për tu ngjitur deri në majë, vështirësitë dukeshin të shumta. Terreni i thyer, elementet e natyrës, domosdoshmëria e aftësive fizike, etj., kanë qënë ndër ato arsye, që më së shumti kanë ndikuar në atë, që shumica e njerzve t'i shohin nga larg e me frikë majat e maleve. Ka edhe popujt që në maja malesh kanë vendosur forcat keqbërëse të natyrës.

Porse gradualisht, ndër shekuj, herë këtu e herë atje, njerëzit, kryesisht intelektualët, filluan t'i shohin malet si vende kënaqësi-dhënëse e po kështu edhe ngjitjen në to. Shekulli i tetëmbëdhjetë përgatiti terrenin, që në Alpet e Evropës të vijnë e të tentojnë të ngjiten ndër maja gjithnjë e më shumë dashamirës të natyrës. Aristokracia Britanike ishte në pararojë. Erdhi një kohë dhe gjithnjë e më shumë njerëz, po e shihnin ngjitjen e malit si një argëtim. Kjo gjë u bë modë në kohën e romantizmit dhe një ditë dy burra, Michael-Gabriel Paccard dhe Jacque Balmat, arritën të ngjisin majën më të lartë të Alpeve, Mont Blanc. Kjo ndodhi më 8 Gusht 1786. Ata, si dhe bashkëkohasit e tyre, nuk e dinin se arritjen e tyre njerëzimi një ditë do e rregjistronte si datën e lindjes së një sporti të ri, atë të ngjitjes në majën e një mali.

ALPINIZËM

Lindja

Djepi i sportit të alpinizmit është Mali i Bardhë (Mont Blanc, 4.810 metra mbi nivelin e detit). Mont Blanc nuk është vetëm mali më i lartë i Alpeve të Evropës; ai është gjithashtu një masiv me mijëra, faqe që shtrihet në gjatësi për mbi pesëdhjetë kilometra, me një gjërësi maksimale prej pesëmbëdhjetë kilometra. Akujt e bora e përherëshme në masiv, mbulojnë një sipërfaqe prej 120 kilometra katrore.

Eshtë viti 1760: Horace-Benedict de Saussure, natyralist nga Gjeneva, në moshën njëzetë vjeçare filloi që i vetëm të vizitojë akullnajat e Shamonisë. Ai shkoi në Montanvers dhe u ngjit në majën Le Brevent, e prej ku mundi të shohë e të admirojë Malin e Bardhë. Duke kuptuar vlerën shkencore të majës, e cila ngrihej mbi të tjerat, ai ofroi një shpërblim të majmë për personin e parë që do të gjente itinerarin për në majë. Porse historia e shpërblimit u harrua, ngase u deshtën të kalonin edhe 26 vjet që të gjindej itinerari.

Michel Gabriel Pacard pat lindur në Shamoni. Që herët, ai tregoi një interesim të veçantë për shkencat natyrore dhe i pëlqente të bridhte nëpër male. Ai studioi medicinë dhe u bë mjeku i parë i rajonit. Ndër pacientët e tij, ishin edhe gruaja dhe vajza e Jacques Balmat, me motrën e të cilit ai u martua dhjetë vjet pasi u ngjit në Malin e Bardhë.

Tentativat e Michel-Gabriel Paccard për ngjitjen në majë të Mont Blanc (Mali i Bardhë, 4810 metra mbi nivelin e detit) kishin filluar që në Shtator të vitit 1775, kohë kjo kur ai u ngjit në Montane de la Cote dhe në Akullnajën Taconaz, së bashku me botanistin Skocez Thomas Blaikie. Ata arritën të ngjiten jo më lart se rrëza e shpateve të pjerrta të Dome si dhe Aiguille du Gouter.

Më 1786, Dr. Michel-Gabriel Paccard, i cili kish pas qenë larguar për ca vite nga krahina, punonte si mjek në Shamoni dhe në letrën që i pat dërguar kolegut të tij de Saussure (Horace Benedict de Saussure) në Gjenevë e përshkruan Malin e Bardhë si “mali ynë.” Sipas Paccard,

‘askush jashtë Shamonisë nuk duhet të ketë nderin që të ngjitet i pari në të’. Ndërkohë, duke u ngjitur në majë, ai donte që të provonte se llogaritjet rreth lartësisë së malit ishin të gabuara (dhe në fakt mali ishte edhe më i lartë nga sa mendohej më parë). Ky ishte synimi i tij kryesor dhe njëherësh forca shtytëse për të ngjitur Malin e Bardhë.

Jacque Balmat, banor i krahinës e kërkues kristalesh, u përfshi në synimin e ngjitjes në Mont Blanc vetëm vonë. Ai kishte meritën se kishte zbuluar itinerarin e rëndësishëm nga Grand Plateau për tek kreshta e thjeshtë që të nxirrte në majë. Dy muaj para ditës së fitores mbi majën, gjatë një tentative të vetmuar, atë e zuri nata dhe u detyrua ta kalojë atë në lartësinë gati 4.000 metra, në një gropë të gërmuar në borë me alpenshtokun e tij dhe duke patur vetëm rancin për ‘mbuluar.’ Ndonëse ishte një përvojë e hidhur, kjo ishte për të njëherësh prova për të kapërcyer frikën e trashëguar tek ngjitësit e lartësive për kalimin e natës në akull, e cila deri në atë kohë kish penguar tentativat e ngjitësve malorë në luginat Saint-Gervais dhe Chamonix (Shamoni).

Balmat nuk ishte popullor midis udhërfyesve të tjerë të luginës, por ai gjeti një shok entuziast në natyrën e Michel-Gabriel Paccard-it. Të dy këta e dinin, se seicili ishte rivali më i madh për tjetrin në garën për të arritur majën dhe kjo ishte një nga arësyet, që ata vendosën se ishte më mirë që të bashkonin forcat se sa të tentonin ndarazi.

Me datën 7 Gusht 1786, Balmat dhe Pacard e lanë Le Prêtre (Shamoni) mbasdite herët, duke patur me vehte një batanie, një termometër, një barometër dhe dy alpenshtokë e kaluan natën midis dy shkëmbejve në krye të Montagne de la Côte.

Në ora 4 të mëngjesit të datës 8 Gusht ata filluan t’i ngjiten akullnajës dhe më ora 5 mbasdite u dalluan nga Baroni von Gersdorf nëpërmjet tejqyrës së tij në krye të Rochers Rouges (Shkëmbejt e Kuq), kohë kjo kur Dr. Paccard humbi kapelen e tij, që ia mori një shkulum ere. Baroni dhe ca nga banorët e luginës më 6:12 vrojtuan guximtarët, që filluan ngjitjen e shpatit të fundit dhe arritën të dy majën më 6:23. Aty Dr. Pacard kreu ca matje dhe të dy e filluan zbritjen nga maja më 6:57. Kthimi për tek vendi i kalimit të natës u arrit në errësirë të plotë dhe ishte në vetvehte një bëmë e madhe. Të nesmen Dr. Paccard u gdhi i verbuar nga rezatimi diellor i ditës së maparshme dhe me ndihmën e Balmat të dy u ulën në luginë më datën 9 Gusht pas katër orë zbritje.

Veç faktit se ngjitësit arritën pikën më të lartë të qendrës së kontinentit (e cila në vetvetë është një bëmë e madhe), këta dy burra të Shamonisë kishin zgjidhur problemet ambientaliste e teknike që nxirrnin malet e Alpeve. Ngjitja e parë e Malit të Bardhë nuk ishte vetëm një fitore a pushtim gjeografik (ashtu sikundër u bënë më vonë ngjitjet në majat e tjera më të larta të kontinenteve), por njëherësh ajo demonstroi se njeriu mundej të ngjitej në shpatet e mbuluara nga bora, mundej tu shmangej krevasave dhe serakave kërcënuese për jetën e kalimtarit, që udhëton përmes tyre dhe njëherësh të kënaqë vehten gjatë gjithë këtij procesi.

Ngjitja e majës nga “shpikësi” i Mont Blanc, Horace Benedict de Saussure, 1787. Karvani i ngarkuar rëndë e la Shamoninë më 1 Gusht 1787. Tetëmbëdhjetë udhërfyes, përfshirë Jacques Balmat, u deshtën që të mbartin pajisjet e rënda shkencore. Porse veç këtyre pajimeve Saussure mori mjaft pajisje personale si: ombrellë, tendë, shtrat portativ e shtrojat për të, të linjta, batanie; dy pallto, tre xhaketa, tre jelekë, gjashtë këmisha, një kostum udhëtimi, një kostum të bardhë; këpucë, kambale, një palë këpucë me majucë, dy palë këpucë me majë të shkurtër, e madje edhe një palë... pandofla. Një aristokrat i klasit më të lartë, që i kënaqej komfortit të tij edhe për ngjitjen e Pullazit të Alpeve.

Pas tre ditësh të përpjekjeve të mëdha ekspedita e parë shkencore e tij ja arriti qëllimit; u ngjit në majën Mont Blanc. Ekspedita mundet të shërbejë si një model për këdo që ndërmerr ngjitjen e Mont Blanc sipas atij itinerari.

Saussure ishte i pari që zbuloi ligjet bazë të glaciologjisë (shkencës së studimit të akullnajave). Ai përkreu instrumentin e quajtur higrometri me qime. Të dhënat e vëzhgimet e tij, që përshkruajnë teknikat e përdorura për ngjitje nga pionierët e alpinizmit, patën jehonë për kohën e madje mbeten një vlerë e madhe edhe në ditët tona.

Femra e parë në Malin e Bardhë, 1808. Ngjitja e majës nga Marie Paradis ishte një përpjekje e mundimshme. Udhërëfyesit e kishin bindur atë: “Ti je një vajzë e mirë dhe ti ke neovjër që të fitosh. Eja me ne; të huajt do kenë dëshirë të të shohin arritëse dhe do jenë krenarë me ty.” Ajo u bind, u nis dhe u ngjit dhe kur arriti majën atë e kishin tërhequr, mbajtur shtrirë dhe gjysmë e vdekur, tek arriti majën ajo u bë femra e parë, që u ngjit në majën e Malit të Bardhë.

Tridhjetë vjet më vonë, më 1838, i erdhi rradha femrës së dytë që të ngjitej në majë. Ajo quhej Henriette d'Angeville. Kjo femër syapatrembur, në mënyrë të përpiktë përgatiti ekspeditën e saj. Ngjitja e saj fitoi admirimin e udhërëfyesve që e shoqëronin të cilët, e quajtën “E fejuara e Malit të Bardhë.

Ekipi i parë Shqiptar në Malin e Bardhë

Shoqata Dajti Alpino-Turistik e qytetit të Tiranës, organizoi e stërviti një ekip alpinistash për ngjitjen e Malit të Bardhë. Më 26 Gusht 2008 tetë alpinsitë arritën në luginën e Shamonisë. Këta ishin: Aleksander Bojaxhi, Ibrahim Haçkaj, Xhim Begeja, Gjergji Bojaxhi, Armand Hallvaxhi, Florijon Haçkaj, Marenglen Laçi dhe Mateo Begeja.

Përkujdesjet për ekipin në Shamoni u treguan nga anëtarë të shoqërisë së guidave në Shamoni. Më datë 27 Gusht me ekipin u organizua një stërvitje prej katër orësh në akullnajën Mer de Glace, e cila rrjedh në pjesën veriore të masivit malor Mont Blanc.

Të nesërmen, më 28 Gusht, u synua maja Mont Blanc. Më ora 12:30 ekipi arriti lartësinë 3.200 metra mbi nivelin e detit. Këtu, për arsye të dëmtimeve fizike, u ndalën Aleksander Bojaxhi dhe Xhim Begeja, të cilët u akomoduan në strehimin Tête Rousse (3.160 m). Pjesa tjetër e ekipit u ngjit më lart dhe e kaloi natën në strehimin du Gouter (3.817 m).

Më datë 29 Gusht, gjashtë anëtarë të ekipit: Ibrahim Haçkaj, Gjergji Bojaxhi, Armand Hallvaxhi, Florijon Haçkaj, Marenglen Laçi dhe Mateo Begeja u nisën më ora 3:00 të mëngjesit dhe sulmuan majën Mont Blanc, ku dyshja e fundit arriti në majë më ora 08:12. Pas një qëndrimi të shkurtër alpinistët morrën rrugën e zbritjes dhe më ora 12:00 patën një pushim të merituar në lartësinë rreth 3.200, metra ku u takuan edhe me alpinistët Aleksander Bojaxhi e Xhimi Begeja. Pas tre orësh të tjera zbritje ekipi arriti në lartësitë ku sigurohej transport me tren e teleferik dhe u ul në luginën e Shamonisë.

Ngjitja, e cila në vetvehte ishte ma shumë një sfidë fizike se sa teknike, ishte tej mase përvojë pozitive alpinistike, e më gjërë, si dhe kënaqësive të mëdha. Por mbi të gjitha ngjitja në majën e Malit të Bardhë ishte një detyrim i vonuar i alpinizmit shqiptar për të nderuar malin i cili “shpiku” sportin e alpinizmit.

të maleve nga të rinjtë e kohës si gjatë sezonit veror, edhe atij dimëror. Në vitet 1959 e 1960 u realizuan edhe aktivitete alpinistike verore, si brenda e jashtë vendit me alpinistë gjermanë, çekë e sovjetikë, të cilat vlejën në përvojën e atij brezi alpinistësh.

Vitin 1964 e vlerësoj si një vit batinë të zhvillimit të alpinizmit veror në Shqipëri. Këtë vit, nën nismën dhe drejtimin e të ndjerit Prof. Minella Kapo, u studjua vlera alpinistike e Bjeshkëve të Nemuna, si dhe u formësua litarimi për realizimin e ngjitjes së malit me kacavarje. Mënyra se si u realizuan ngjitjet e sezonit veror më 1964, mbeti mënyra me të cilën u realizuan ngjitjet alpinistike verore deri më vitin 1990.

Ndërkohë, ngjitjet më cilësore alpinistike (d.m.th. më të vështirat nën vështirimin teknik) të sezonit dimëror (periudha 22 Dhjetor – 21 Mars) kaluan gradualisht nga ngjitjet në maja të veçanta në ngjitjen e majave përgjatë kreshtave malore me ditë të zgjatura të kampimit dhe të qëndrimit në lartësi. Fundi i viteve 80-të besoj se do të kujtohet si koha, kur në sezonin dimëror filloi edhe realizimi i itinerarëve për në majë të malit me kacavarje.

Në shekullin që jetojmë, për lëvizjen tonë alpinistike vlen të theksohet vajtja e një ekspedite në zonën e Himalajave. Ekipi shkeli më 24 Prill 2003 në Kampin Bazë (5.364 m) nga ku sulmohet maja Everest (8.848 m), pullazi i rruzullit tonë, dhe të nesërmen u ngjit në majën Kalapathar (5.545 m).

Veçori të sportit të Alpinizmit

Alpinizmi është sporti i ngjitjes së maleve. Më saktë, alpinizmi është sporti i ngjitjes në majën e një mali duke zbatuar teknika të kapërcimit të relievit malor dhe me raste edhe duke zgjidhur probleme taktike e organizative të paramenduara dhe/ose të çastit.

Alpinizmi ka veçoritë e tij karakteristike, sikundër çdo sport tjetër i ka të tijat, si:

- Nuk ka aktivitete ku garojnë sportistë ose ekupe sportive midis tyre.
- Është një sport i llojit të një ushtrimi dëfryes. Ai është kënaqësidhënës dhe kënaqësia vjen nga sfidimi i relievit malor dhe i elementëve të natyrës nëpërmjet përpjekjeve individuale, kolektive, ose të dyja bashkë.
- Alpinisti ose ekipi alpinistik përballet jo me individë, por me relievin malor dhe me elementët e natyrës.
- Itinerari i arritjes në majë zgjidhet nga vetë individi, ose ekipi mbi bazën e synimit apo dëshirës, aftësive për kapërcimin e relievit si dhe faktorëve të tjerë dytësorë.
- Arritja alpinistike vlerësohet nga komuniteti alpinistik me masën e kënaqësisë shpirtërore dhe të madhësisë së sfidimit të relievit, por edhe të elementëve atmosferikë, që lë në të (komunitet) itinerari i realizuar nga individi, ose grupi i alpinistëve.
- Ushtruesit e alpinizmit janë njohës, mbështetës dhe veprimtarë të problemeve bashkëkohore të mbrojtjes së natyrës.

Si realizohet një ngjitje alpinistike?

Për të realizuar arritjen në majën e një mali alpinisti përdor:

- A. Paisje të veçanta.

- B. Mënyra sigurimi të vehtes dhe të bashkëngjitësve.
- C. Teknika të kalimit të relievit.

A.

Pajisjet alpine janë mjete, të cilat ndihmojnë alpinistin për të kaluar një reliev të ndryshëm nga ai që ne kalojmë tek kryejmë një ngjitje nëpër një rrugë të thjeshtë në natyrë. Ato bëjnë të mundëshme kalimin e itenerarëve të vështirë. Thënia “itenerar i pakalueshëm” e thënë nga një gjeneratë/brez alpinistësh, ka rënë poshtë me shpikjen e pajisjeve të reja për ngjitje, si dhe me përkryerjen fizike e akrobatike të alpinistëve. Sot janë të shumta pajisjet që përdorin alpinistat dhe këtu do ndalemi në ato që janë më të domosdoshme.

Kazma alpine. Një shkop i ka shërbyer mjaft herët njeriut si pajisje (mjet) ndihmëse në ecje, veçanërisht të moshuarve. Alpinistët e parë përdornin alpenshtokun, një shkop më i gjatë se një shtat njeriu me një fund metalik të majëzuar e me pjesën e sipërme gjithashtu metalike e të formës së përshtatëshme për të thyer akullin apo për të gërmuar borën e ngrirë. Alpshtoku (shkopi i alpeve) me kalimin e kohës erdhi dhe u përmirësua, duke na dhënë atë, që sot quhet kazëm alpine. Të dyja janë “një lloj shkop” dhe konsiderohen “dorë e zgjatur” e alpinistit: kazma ndihmon ngjitësin që të mbështetet (ashtu sikundër mbështetet një i moshuar në shkopin e tij), të përpunojnë relievin (duke goditur me të truallin, akullin apo borën e ngrirë), etj.

Plenga u shpik më 1911 dhe ndihmoi dukshëm në kapërcimin e relievëve “të pakalueshme” ngaqë krijoi mundësi për sigurimin e filltarit (atij që udhëheq ngjitjen për çastin) si dhe anëtarëve të tjerë të grupit alpin. Është një kunj metalik me një “vesh” të çpuar ku kalohet karabina. Plengat janë të llojeve të ndryshme në madhësi e formë dhe ndahen në plenga që ngulen në akull dhe plenga, që ngulen në shkëmb.

Karabina është një unazë metalike me një mshelës, i cili ndihmon futjen e karabinës në veshin e plengës si dhe futjen në karabinë të litarit sigures.

Litari punohet nga fije sintetike me fortësi të lartë. Prodohet në gjatësi të ndryshme, por standartet më tipike janë nga 30 në 60 metra, kurse diametrit më të parapëlqyer janë nga 8 në 11 milimetra.

Kthetrat janë një pajisje metalike, sot kryesisht me 12 “dhëmbë,” që u vishen këpucëve për të kaluar relievin e mbuluar me akull apo borë të ngrirë.

Kofshore (gjoksore) është një pajisje e punuar me pjesë litari, ose rripash, ose lëkure (apo edhe kombinime të tyre) e cila, mbërthehet në pjesën lombare (ose edhe në gjoks) të alpinistit.

Majthi, pajisje metalike me anën e të cilit ngulen në shkëmb, ose në akull plengat.

Ranci, është një çantë shpine me rripa. Sot punohen me bërore (shpor), gjë që mundëson mbajtjen e një peshe të ndjeshme, por të shpërndarë mirë nëpër shpinën e mbartësit (alpinistit).

Tenda, është “shtëpia” e alpinistit. Bashkë me *thesin e fjetjes* dhe *shtrojen veçuese* me truallin sigurojnë mundësinë e vendin për fjetje.

Lista e pajimeve alpinistike ndërtohet mbi bazën e itenerarit që do të ndërmerret për tu ngjitur. Sa më i vështirë e më i gjatë itenerari, aq më të shumëllojshme janë pajimet që merren e aq ma shumë copë për çdo artikull merret. Skica e maposhtëme ilustron rastin e pajisjeve, që nevojiten për një ngjitje nëpër një itenerar jo të thjeshtë.

B.

Alpinistët e kanë litarin pajisjen kryesore në sigurimin e vehtes dhe të njëri tjetrit gjatë një ngjitje. Ata mësojnë lloje të ndryshme lidhjesh me litar të të njejtit diametër, ose midis litarëve me diametra të ndryshëm. Lidhjet (nyjet) alpinistike nuk janë lidhje dosido, por të ndërmendura që së pari të jenë të qëndrueshme dhe së dyti, shpesh të përcaktuara nga një qëllim i caktuar i përdorimit të litarit (qëllimit i përgjigjet një nyje e caktuar).

Ka raste, kur alpinisti për distanca prej pak metrash mundet të ngjitet pas litarit (jo filltari) dhe rëndom, kur nuk ka rrugë të thjeshta zbritje, ai apo i gjithë grupi ku bën pjesë, detyrohet të ulet duke përdorur litarin. Në këto raste, veç nyjeve që përdoren, sot ka pajisje, të cilat mundësojnë si ngjitjen edhe zbritjen, duke lehtësuar dukshëm ngarkesën fizike të krahëve të alpinistit.

Kujtdo nga ne, pasi ngjitemi në një reliev të vështirë dhe shkëputemi qoftë edhe 2 a 3 metra nga pika e nisjes dhe hedhim sytë poshtë, normalisht i lind pyetja: “Po sikur të bie, a do të dëmtohem?” Kjo pyetje, kërkon përgjigje sigurie për mos dëmtim që ngjitesi të ketë bindjen dhe mbështetjen e tij psikologjike për të vazhduar ngjitjen ma tej. E për të siguruar vehten çdo ngjites apo edhe kacavarës, zbaton teknikat e sigurimit.

Le të mendojmë një litarim me tre, domethënë një renditje tre alpinistësh të lidhur në një litar. Njëri prej tyre paracaktohet filltar (udhëheqës i ngjitjes), i dyti quhet mestar dhe i treti përmyllës (i dyti dhe i treti quhen njëherësh edhe ndjekës). Si rregull filltari është personi më me përvojë në ngjitje, por jo domosdo. Grupi ka me vehte një sasi e llojshmëri pajisjesh të cilat janë menduar se do duhen që të përdoren në reliev për të arritur synimin.

Së pari, aty ku fillon relievi i vështirë ata mbërthejnë në trup kofshoret dhe nxjerrin litarin kryesor e lidhen me të. Le të mendojmë se litari i tyre është 40 metra i gjatë. Dy prej ngjitesve lidhen me skajet e litarit dhe njëri me mesin (paraprakisht i shënuar) e litarit. Ata bëjnë nga një nyje të veçantë në litar, të cilën nyje e kalojnë në karabinën e vendosur në kofshoren (ose gjoksoren) e tyre. Kështu, karabina në këtë rast është një ndërmjetëse, e cila lidh një “pikë” të litarit me kofshoren që ka mbërthyer në trup sejcili prej tyre.

Tani le të mendojmë se kjo treshe do të fillojë ngjitjen (do të kalojë relievin e vështirë) në itenerarin e parapërcaktuar për ta kaluar. Ai që do të ngjitet i pari, thamë se quhet filltar. Ai fillon të kacavarë dhe pas një a më shumë metrash kacavarje ngul një plengë në një të çarë a plasë që ka shkëmbi duke e goditur atë me majth. Në veshin e plengës ai kalon karabinën, e në këtë të fundit kalon litarin, që shkon nga gjoksi a kofshorja i tij për tek pjestari i grupit që është i lidhur me mesin e litarit (mestari). E gjithë kjo procedurë quhet *sigurim* dhe krijon një pikë siguruese për ngjitesit.

Pas kësaj, ai e vazhdon edhe 3 a 4 metra kacavarjen (kjo varet kryesisht nga relievi) dhe ngul një plengë të dytë dhe pas kësaj kryen të njejtat veprime sikundër bëri pas nguljes së plengës

së parë (pra bën një *sigurim* të dytë, apo krijon një pikë siguruese të dytë). Filltari do të vazhdojë kështu, deri sa litari me gjatësi 20 metra që është ndërmjet tij dhe mestarit, (i dyti në rrjeshtim) të “hapet” e ai të mos ketë mundësi të ngjitet ma tej pa “lëvizur” mestari.

Ndërkohë që filltari përparonte duke u kacavarur, mestari luan rolin e *siguruesit* për filltarin. Detyra e tij është që të pozicionojë vehten sa ma mirë ndenjtur, ose në këmbë dhe duke e kaluar litarin nëpër trupin e tij, ose nëpër karabinë, etj., e duke e mbajtur atë nën kontroll me të dyja duart, e “lëshon” atë, teksa filltari përparon. Tek e lëshon litarin, ai duhet ta bëjë lëshimin aq sa ai të jetë paksa i lirë dhe jo i tendosur midis të dyve, gjë që do e vështirësonte lëvizjen e filltarit. Pra, ka shumë rëndësi që litari midis filltarit dhe mestarit të mos jetë i tendosur, por paksa i lirë. Mestari (siguruesi) e realizon këtë nëpërmjet të të ndjerit të litarit në dorën e tij, (përvojë që fitohet shpejt) si dhe hera-herës duke vepruar sipas kërkesave të filltarit. Kjo lloj lirëshmërie e litarit (në kufijtë e tendosjes) nevojitet jo vetëm që të mos bëhet pengesë për filltarin (i cili do detyrohet ta tërheqë atë kur e ka të tendosur mbasi do e pengojë në lëvizje), por edhe për të garantuar siguri në rast se filltari bie (rrëzohet). Nëse ndodh kjo e fundit, atëherë ai do të bjerë pak më shumë (kjo varet nga masa se sa i “lirë” është litari ndërmjet filltarit e mestarit) sa dyfishi i distancës nga plenga ma e sipërme e ngulur deri tek filltari.

Pikërisht, fakti se në rast rrëzimi filltari do bjerë në këtë masë dhe fakti se pas rënies ai mbetet i varur në litar tek plenga më të sipërme e ngulur në shkëmb, i jep atij siguri për jetën dhe e mbështet atë psikologjikisht që të kacavaret lart e ma lart.

Për lexuesin natyrshëm lindin një sërë pyetjesh si: Sa i sigurtë është litari? Thënë ndryshe, Sa mban ai? Sa e sigurtë është plenga e ngulur? Po karabina?

Litari, që përdoret brënda standardeve të rekomanduara nga prodhuesit e tij, mban më shumë se një alpinist në goditjen e rrëzimit. Kjo është e llogaritur që në prodhimin e tij dhe si për litarin edhe për pajisjet e tjera alpinistike Organizata Ndërkombëtare e Lidhjeve Alpinistike (UIAA) lejon vetëm shitjen e materialeve alpinistike që kanë aprovimin e saj, si dhe rekomandon vetëm blerjen e këtyre pajisjeve si masë garancie për jetën e alpinistit dhe gjithë atyre që për qëllime sportive ose civile përdorin pajisje alpinistike. Nga ana tjetër, përvoja u mëson alpinistëve për faktin se kur plenga e ngulur prej tyre është e sigurtë, e kur jo e sigurtë. Vlen për t’u theksuar, se në shumicën dërmuese të vendeve ku ushtrohet sporti i alpinizmit, shoqatat a lidhjet alpinistike kanë mundësuar që në itinerarët më popullore për ngjitje, plengat të jenë të ngulura e fiksuara një herë e pëgjithmonë dhe alpinisti nuk ka nevojë, në këto raste, të përdorë plengat e tij.

Le të kthehemi tek momenti që filltari u ngjit në të gjithë gjatësinë e litarit, midis tij e mestarit. Në fakt, kur mestari sheh se filltari ka edhe rreth 5 metra litar për të përparuar, ai e njofton filltarin dhe ky i fundit, në vartësi të relievit, fillon e mendon se ku mundet të organizojë ankorimin e tij. Me ankorim kuptojmë një proces veprimesh: filltari do të ngulë të paktën një plengë (ose edhe më shumë) dhe do të organizojë “lidhjen” e tij në këto plenga, duke bërë njeje në litar e duke i futur ato në karabinat e shkuara në veshin e plengave e ngulura. Kështu, pasi ai siguron vehten (thënë ndryshe, ‘lidh vehten me reliev’, pra ankorohet në reliev), ai mundësohet që të bëhet sigurues i mestarit duke i dhënë mundësi atij, të fillojë kacavarjen e të ngjitet deri në pikën ku ka arritur.

Teksa mestari fillon kacavarjen, për të vajtur tek filltari, ky i fundit nis dhe e tërheq (mbështjell) litarin, ngaqë largësia midis të dyve vjen e zvoglohet, por pa e tendosur atë. Në këtë kohë, i treti në grup, përmbyllësi, e lëshon (e jep) litarin (sikundër bënte mestari teksa ngjitej filltari). Si filltari dhe përmbyllësi bëjnë kujdes që mestari të mos e ketë litarin as të lirë e as të tendosur, si nga lart edhe nga poshtë. Teksa mestari ngjitet, kur arrin tek sejcila plengë ai fut në karabinë litarin që shkon nga vetja e tij për tek përmbyllësi dhe nxjerr nga karabina litarin që shkon prej tij tek filltari. Pasi ngjitet dhe bashkohet me filltarin, ankorohet aty dhe përshtatet në atë relief që të sigurojë filltarin për të përparuar ma tej. Ky i fundit, tashma rifillon kacavarjen, si dhe ngul plenga e kryen veprimet me karabinë e litar të spjeguar si ma sipër. Kjo do të vazhdojë deri sa përsëri të “hapet” i gjithë litari i mundëshëm midis tij e mestarit. Kur arrihet kjo, filltari përsëri organizon ankorimin e tij të ri.

Tashmë, i gjithë litari është i hapur në shkëmb dhe vjen radha e përmbyllësit që të kacavaret (ngjitet). Atë e siguron duke e tërhequr (mbështjellë) litarin mestari, deri sa ata bashkohen të dy. Gjatë kacavarjes, përmbyllësi nxjerr me majth nga shkëmbi plengat e ngulura, si dhe merr nga relievi çdo pajisje tjetër që është përdorur nga filltari dhe këto materiale ai ia dorëzon mestarit, i cili pasi rifillon kacavarjen dhe bashkohet me filltarin, ia dorëzon atij këto materiale. Kjo mënyrë lëvizje e grupit vazhdon sa kohë, që ngjitesit janë të detyruar të përparojnë drejt majës duke u siguruar. Tabela më poshtë ilustron edhe një herë rendin e lëvizjes, (njëmbëdhjetë lëvizje) duke i emruar ngjitesit me numurat 1, 2 dhe 3.

Vendosja e alpinistëve pas çdo ankorimi					
Fillimi	1,2,3 (janë të tre bashkë)				
Lëvizja e parë	2,3	1			
Lëvizja e dytë	3	2,1			
Lëvizja e tretë	3	2	1		
Lëvizja e katërt		3,2	1		
Lëvizja e pestë		3	2,1		
Lëvizja e gjashtë		3	2	1	
Lëvizja e shtatë			3,2	1	
Lëvizja e tetë			3	2,1	
Lëvizja e nëntë			3	2	1
Lëvizja e dhjetë				3,2	1
Lëvizja e njëmbëdhjetë				3	2,1
Lëvizja e dymbëdhjetë				3	2.....

Në këtë tabelë lëvizja vertikale, me rreth 20 metra, e ngjitesve 1, 2 e 3 pasqyrohet me lëvizjen e numurave nëpër kollona nga e majta në të djathtë.

Kjo mënyrë lëvizje, siguron ngjitesit që të mos dëmtohen deri në humbjen e jetës, në rast rrëzimi. Sigurisht, që është një lëvizje e ngadaltë, por ka rëndësi për këdo që është e sigurtë për jetën. Përshkrimi i lëvizjes së tre alpinistëve të lidhur në një litar si më sipër, është bërë duke

menduar një reliev shkëmbor, por ajo është e njëlojtë edhe sikur relievi me vështirësi teknike të jetë i mbuluar me akull ose borë. Litarimi mundet të formohet edhe me dy alpinistë, një filltar e një përmbyllës. Në këtë rast, rritet ndjeshëm shpejtësia e ngjitjes.

Gjatë kalimit të relievit të vështirë alpinistët komunikojnë midis tyre. Komunikimi është shumë i ngjeshur dhe i prerë, ngase kërkohet përqëndrim maksimal e jo fjalë. Ai lidhet kryesisht me gatishmërinë e siguriesit për atë që do të lëvizë në litarim. Ja një shembull ilustrues i komunikimit para fillimit të lëvizjes (kacavarjes):

Ai që lëviz: sigurimi gati?

Siguruesi: gati!

Ai që lëviz: po nisem.

Siguruesi: të siguroj.

Ky komunikim, më i rëndësishmi, është i domosdoshëm, ngase ai që do të lëvizë ka nevojë që të jetë i siguruar nëpërmjet gatishmërisë së manovrimit (frenimit) me litar, nëse ai bie, kurse sigurusit ka nevojë të jetë i vendosur në mënyrë të tillë aty, ku është ankoruar, që për manipulimin e litarit që do i duhet të bëjë gjatë lëvizjes së shokut, të ketë qëndrueshmëri sa më të larë në pozicionimin e tij.

Kur grupi i alpinistëve arrin majën, veç përshëndetjeve e përqafimeve mes tyre për arritjen, ata lëshojnë në efir thirrjen e tyre: Zik-zak, zik-zak, hej, hej, hej alpinista jemi ne!

C.

Format e relievit i kanë shtyrë alpinistët të mendojnë e të krijojnë teknika të veçanta për kapërcimin e tij. Këto teknika kanë veçori të ndryshme në vartësi të faktit se relievi është shkëmbor apo i akulltë, me pjerrësi normale apo të theksuar, etj.

E veçanta për relievin e mbuluar me akull apo borë të ngrirë është se alpinistët ngjiten a kacavaren duke mbathur në këpucë kthetra me 12 dhëmbë, ku një çift dhëmbësh dalin thuajse në drejtim vertikal. Me to alpinisti godet akullin (apo borën e ngrirë) kur ngjitet në faqe me pjerrësi të madhe dhe ngulja e kthetrave në masën e ngrirë siguron “kapjen” në akull. Duke marrë në sejcilën dorë edhe nga një kazëm cap (kazëm akulli), të cilat ngulin majën kur godasim akullin me to, ngjitësi përparon edhe në relievin e akullt vertikal.

Format e relievit shkëmbor, si dhe format e relievit në borë apo akull, për t’u kapërcyer në rrugën drejt majës së malit, kanë krijuar artin e kapërcimit të tyre. Ilustrimet e mëposhtme përçojnë tek ju si lexues, disa nga teknikat që përdoren për këtë qëllim e që lidhen kryesisht me vendosjen e duarve apo këmbëve, si dhe pozicionimin e trupit në këto relieve.

Itenerari i ndërmarrë për arritjen e majës së malit klasifikohet në shkallë vështirësie. Ka sisteme klasifikimi të ndryshme dhe në vendin tonë është përdorur sistemi i vlersimit nga një (më i thjeshti) deri në gjashtë (më i vështiri).

Paragjykim: alpinizmi është sport me rreziqe të shumta dhe ata që merren me alpinizëm luajnë me vdekjen.

Këto nuk janë të vërteta: një pjesë e këtij paragjykimi i ka rrënjët në mungesën e dijeve për këtë sport, kurse një pjesë tjetër e paragjykit ndërtohet nga ata alpinistë, të cilët janë nga ana sportive të nivelit mediokër apo që janë psikologjikisht emocionalë. Kjo kategori, i përjeton me frikë ngjitjet e kryera dhe e ndjejnë vehten "heronj" për realizimet e tyre. Nuk mungojnë alpinistë të tillë, që janë shkrimtarë ose punonjës të medias. Me raste, këta e përcjellin frikën e tyre nëpërmjet bisedave me të njohur, shkrimeve si dhe mediave dhe ngizin kështu keqinformim në ata që nuk kanë kulturë për alpinizmin.

Alpinisti i mirëfilltë i ngjitet malit jo për tu mburrur, jo për tu aksidentuar, e jo e jo për të vdekur. Kur kthehet nga mali ai, askujt nuk i transmeton "heroizma" që ka kryer apo "tmerre" që ka përjetuar, por kënaqësitë e sfidave me të cilat e ballafaqon ngjitja e malit. Ato të frymëzojnë, të shtojnë emërgjitë për tu ndeshur e për të kapërcyer vështirësi të tjera në të ardhmen. Vështirësitë e itenerarëve që ndërmerralpinisti i llogarit mbi bazën e përvojës dhe përgatitjes fizike dhe i hyn realizimit të tyre me llogari të bëra mirë. Edhe dështon, por nuk rrezikon.

Itenerarët janë të vështirësive nga ma të ndryshmet. Përvoja të mëson të ndërmarrësh atë të cilin mundet ta realizosh dhe që në realizim e sipër të jep kënaqësitë e ndeshjes dhe triumfit mbi relievin dhe elementët e natyrës. Kjo është një ndër bukuritë e alpinizmit.

Fushimi (kampimi)

Për t'u ngjitur në mal, alpinisti pasi përgatitet fizikisht e teknikisht si dhe paramendon një plan për arritjen e majës, nisat me mjetet e mundëshme të komunikacionit dhe i afrohet sa ma shumë malit, maja e të cilit synohet që të ngjitet. Me raste, aty ku rruga e makinës nuk shkon ma tej, mundet të pajtohen kafshë barre, për të mbartur rancat sa më lart e sa ma pranë vendit ku fillojnë vështirësitë e itenerarit.

Paragjykim: alpinistët parapëlqejnë mbartjen e ngarkesave në shpinë. JO! As alpinistët e as dashamirësit e natyrës (ata që dalin për të soditur ose për të kaluar ditët e pushimeve në natyrë) nuk kanë dëshirë të mbartin. E vërteta është krejt e kundërta, sepse të shijosh bukuritë e natyrës, apo të sfidosh vështirësitë e relievit nevojitet të jesh sa më pak i lodhur. Andaj dhe alpinistët mbartin aq e rrugëtojnë me barrën në shpinë, aq sa është e domosdoshme për të arritur synimet e tyre në natyrë. Për të minimizuar mbartjen, ata shfrytësojnë sa të mundën mjetet e transportit motorik, por edhe kafshët e barrës për t'ju afruar sa ma shumë vendit më të sipërm të qëndrimit a të fushimit.

Tek arrihet në lartësinë e ndërmendur, ngjitësit organizojnë fushimin (kampimin), i cili kërkon një arsenal të tërë paisjesh, që kanë të bëjnë me jetesën në natyrë. Për fushim zgjidhet një vend që ka ujë, por jo me lagështirë, një vend larg mundësive për përmbytje, të mbrojtur nga era, etj., dhe ngrenë tendat. Për ngritjen e tendës merret parasysht që hyrja e saj të jetë në të kundërt të drejtimit nga pritet të fryjë era dhe rreth saj hapet një "kanalth" i cili, në rast të ndonjë rebeshi me shi mundëson largimin e ujit nga fundshtroja e tendës. Madje, alpinisti tregon kujdes në hapjen e kanalthit: dashamirësi i natyrës e kthen plisin e barit, mbasi kështu kur largohet nga fushimi,

mundësohet rikthimi i plisit (apo plisave) në pozicionin fillestar dhe mundëson riaktivizimin e bimësisë në të.

Fushimi është një proces i cili nuk ka të bëjë vetëm me vendin për ngritjen e tendës: ai ka të bëjë me vendin për kryerjen e nevojave personale, vendin për gatim dhe zjarr, vendin për ngrënie, etj., në vartësi nga ditët e qëndrimit aty. Për këtë e të tjera nevoja organizative e drejtuese, grupi me kohë ka caktuar një anëtar si udhëheqës të tij, që si rregull është anëtari më me përvojë në daljet në natyrë, apo ngjitjet në mal.

Teksa ngjitemi në një mal të ulët ose relativisht të ulët, si rregull, kemi nevojë për një fushim (kampim), ndërsa ngjitja e maleve të larta lind nevojën e ndërtimit të ma shumë se një fushimi. Sigurisht më shumë kampe kërkojnë majat 8.000 metroshe të cilat janë 14 në rruzulin tonë. Për ngjitjen e një 8.000 metroshi, si rregull ngrihet në lartësinë mbi 5.000 metra një kamp i cili emërtohet kampi bazë. Këtu, grumbullohet i gjithë materiali teknik, ushqimet dhe gjithshka që i duhet grupit të alpinistëve për tu ngjitur në majë. Kampi më i sipërm që ngihet, i quajtur ndryshe edhe kampi i sulmit, ndërtohet aq pranë majës së malit që synohet sa të jetë e sigurtë që duke u nisur në mëngjes prej tij, grupi i alpinistëve të mundet të arrijë majën dhe të kthehet shëndoshë e mirë në të ose në një kamp të maposhtëm.

Kampet, që ngrihen ndërmjet kampit bazë dhe kampit të sulmit, quhen kampe ndërmjetëse. Sejcili prej tyre paisjet në atë mënyrë që të jetë furnizues e mbështetës veprimesh për kampet që janë mbi të. Rregulli klasik është, që sa më i sipërm të jetë kampi, aq më i vogël është ai, që d.m.th. më pak tenda të ngritura e më pak pajisje në të. Kjo ngase, po sipas rregullit klasik, në kampin e sulmit grupi i alpinistëve është i vogël (pjesë e grupit të plotë të alpinistëve). Grupi i alpinistëve që sulmojnë majën caktohet nga komandanti i ngjitjes dhe në vartësi të kushteve të motit, pas sulmit të parë, komandanti cakton edhe grupe të tjera për të sulmuar majën duke i kombinuar alpinistët pjesmarrës në dyshe a treshe në bazë të gjykimit të tij.

Kushtet e motit janë vendimtare në arritjen e suksesit në ngjitjet alpinistike, jo vetëm në malet e larta por edhe në ato të ulta. Nuk janë të pakta rastet, kur pasi grupi i alpinistëve ka bërë më të mirën e mundëshme, ditën e sulmit të prishet moti dhe çdo gjë të fillojë nga e para (kur grupi ka ditë rezervë të qëndrimit në mal) ose të kthehet “duarzbrazët” e zemërthyer në vendin nga është nisur.

Kur alpinistët ngjiten në male të larta ata ndeshen me vështirësitë e ajrit të rrallë në ato lartësi. Si rregull, nga lartësia 3.000 metra mbi nivelin e detit e lart, alpinistët, me raste, “goditen” nga sëmundja e malit e cila lidhet me faktin që në lartësi, i rrallë bëhet jo vetëm ajri, por rrjedhimisht edhe prania e oksigjenit në të (në alpinizëm, me humor, për paksimin e oksigjenit në ajër thuhet se “ajri është i hollë”). Sëmundja e malit prek këdo, alpinist apo banor të lartësive të mëdha. Nuk dihet se kur do të preket tjetri: mund të qëllojë që një alpinist të preket nga kjo sëmundje që në ngjitjen e parë që kryen në lartësitë mbi 3000 metra, e mos të preket pas kësaj dhjetë herë të tjera, ose anasjelltas. Kur prekesh nga sëmundja e lartësisë, duhet të ulesh sa ma parë poshtë, e pasi të qetësohesh, të fillosh të ringjitesh duke e fituar lartësinë gradualisht. Të ngjiturit gradual në lartësi e ulja e përkohëshme poshtë quhet aklimatizim. Të ngjitesh 300 metra disnivele të pushosh një ditë, e pastaj të ngjitesh përsëri 300 metra, e kështu me rradhë, duket si formula ma e mirë për të shmangur sëmundjen, por ky është një lluks në fitimin e lartësisë që pakkush e zbaton. Vlen të theksohet se sot, ndërsa nuk dihet nëse do të zërë ose jo sëmundja e lartësisë, dihen fare mirë shenjat e shfaqjes së saj, gjë që ndihmon në marrjen me kohë të vendimit për tu ulur poshtë.

Vlerësime

Për arritjet e tyre sportive alpinistët vlerësohen, sikundër vlerësohen atletët e çdo sporti tjetër. Vlerat e tyre qëndrojnë në cilësinë e ngjitjeve që kryejnë, e për këtë numurohen një a më shumë nga ngjitjet më cilësore të tyre si individë, pamvarsisht se ato arrihen me të paktën një partner. Dhe ngjitje cilësore alpinistike janë ato të cilat, për të arritur majën e malit, kanë më shumë vështirësi teknike. Ngjitjet premierë të një itinerari drejt majës, (ngjitjet për të parën herë) kanë gjithnjë shumë vlerë në botën e alpinistëve. Si rregull, ato ndërmerren nga alpinistë elitë. Shoqëria ka shumë alpinistë, por pak janë ata, të cilët bëhen shembull frymëzimi për brezin e tyre, apo për brezat e ardhëshëm dhe kjo ngase ata vlerësohen, jo vetëm për ngjitjet premierë që kryejnë e meritën e kapërcimit të vështirësive që kanë itinerarët, por edhe për shembullin e tyre moral e shpirtin e vetmohimit gjatë veprimtarive. Vlerësime të veçanta në rafshin ndërkombëtar, në mbyllje të shekullit të kaluar, pati Tirolezi nga Italia, Reinhold Menser.

Kohët e fundit flitet vazhdimisht për *alpinizëm* dhe *alpinizëm bazik*. Kjo ngase në vendet me alpinizëm të zhvilluar, është krijuar dhe rinovohet vazhdimisht një elitë alpinistësh, të cilët ndërmarrin itinerarë shumë të vështirë, të cilët, për t'u kapërcyer kërkojnë përgatitje të veçantë.

Tabela e maposhtëme na njeh me malet ma të larta të Republikës së Shqipërisë të cilat kanë vlera alpinistike:

Emërtimi i majës	Zona ku bën pjesë	Lartësia në metra
Korabi	Vargu lindor	2751
Jezera	Bjeshkët e Nemuna	2694
Popluqes	Bjeshkët e Nemuna	2569
Radohina	Bjeshkët e Nemuna	2569
Gryka e Hapët	Bjeshkët e Nemuna	2525
Hekurave	Bjeshkët e Nemuna	2561
Gavnit	Bjeshkët e Nemuna	2530
Kollatës	Bjeshkët e Nemuna	2555
Madhe (Shnik)	Bjeshkët e Nemuna	2554
Gramozi	Vargu Lindor	2523
Brijasit	Bjeshkët e Nemuna	2567
Vishensit	Bjeshkët e Nemuna	2517
Gjalica	Vargu Lindor	2486
Papingut	Nëmërçkë	2485
Qetat e Arushës	Bjeshkët e Nemuna	2423
Lakojve	Bjeshkët e Nemuna	2499
Tomorit	Tomor	2416
Boshit	Bjeshkët e Nemuna	2416
Qukapecit	Krahina Malore Qëndrore	2417
Shkëlzenit	Bjeshkët e Nemuna	2407
Kulmakut	Tomor	2396
Koritniku	Vargu Lindor	2395
Ostrovicës	Ostrovicë	2383
Guri i Topit	Vargu Qëndror	2380
Velivarit	Vargu Lindor	2375
Valmarës	Vargu Qëndror	2373
Kakisë	Bjeshkët e Nemuna	2360

Faqekuqi	Ostrovicë	2352
Lunxhërisë	Lunxhëri	2160
Çikës	Bregu i Detit	2045

Ka edhe maja të tjera të larta në teritorin shqiptar, e sidomos në Bjeshkët e Nemuna, me ose pa emrim, të cilat janë në lartësitë 2000 – 2500, metra mbi nivelin e detit dhe kanë vlera alpinistike.

Blloku malor me vlerat më të mëdha alpinistike të Shqipërisë janë Bjeshkët e Nemuna, të quajtura nga të huajt edhe Alpet e Shqipërisë. Ky bllok malor, nga ana gjeografike, shtrihet përtej kufijve shtetërorë të Republikës së Shqipërisë: ai përfshin edhe ca nga territori i Republikës së Kosovës, si dhe nga ai i Republikës së Malit të Zi.

Jo çdo bllok malor emërtohet **alpe**: fjala *alpe* në një farë mënyre është një “titull” i veçantë, që i jepet një blloku malor. Sikundër e dimë, relievi i Shqipërisë mbulohet nga male të shumta. Të grupuara ato emërtohen Vargu Lindor, Krahina Malore Qëndrore, etj., por vetëm blloku malor në veri të vendit, Bjeshkët e Nemuna, emërtohen, apo njihen nga të huajt edhe me emrin Alpet e Shqipërisë. Dhe kjo, sepse ky bllok malor ka karakteristika të alpeve: kreshta malore që formojnë lugina të thella e të bukura të përshkruara nga lumej me ujë të kthjellët, pyje që veshin faqet e luginave; mbi pyje kullota të pasura, e mbi to majat e maleve, ku bimësia vjen e bie me rritjen e lartësisë, kurse borërat shekullore bëhen gjithnjë e më shumë pjesë e relievit ma të sipërm të malit.

Të pakta janë vendet e botës që kanë alpe, e ne jemi një nga ato vende. Alpet tona duke patur bukuri të veçantë, krahasuar me blloqet e tjera malore, shpesh i krahasojnë me ato të Zvicrës, që njihen si ndër ma të bukurat. Ja një histori e vogël: në vitin 1994 një alpinist italian pasi u kthye nga një udhëtim tre ditor nëpër Bjeshkët e Nemuna, u shpreh: “Nuk e dija se Zoti kish krijuar në Shqipëri një copë Zvicër.”

Këtu kam rastin të shpreh një mendim personal: më pëlqen që bllokun malor në veri të vendit, ta quajmë të gjithë Bjeshkët e Nemuna a të Namuna (në fakt është një tingull midis e-së dhe a-së për të cilin ne nuk kemi një gërmë), ashtu sikundër e quajmë malësorët, që i popullojnë luginat e tyre. Të huajt, na quajnë *albanians* dhe vendin tonë *Albania*, por ne vetë e quajmë vehten *shqiptarë* dhe vendin tonë *Shqipëri*. Besoj, se shqiptarët nuk kanë se përse të “sillen” ndryshe me emërtesat e maleve që kanë.

Ndoshta, ngaqë Shqipëria duke qënë ndër vite një nga zonat ma të prapambetura të Evropës, ne banorët e saj kemi krijuar kompleksin e inferioritetit edhe ndaj vlerave e bukurive tona natyrore, krahasuar me vende të tjera. Shpesh për vlerat tona, për bukuritë tona, për shumçka tonën, u besojmë më shumë opinioneve të të huajve, se sa vehtes. Në këto dy dhjetvjeçarët e fundit, në mënyrë të ndjeshme, shihet frekuentimi i shtuar i zonave malore për qëllime pushimi nga të huajt e shumë pak nga vetë ne shqiptarët. Tek u besojmë të huajve për shumëshka, le t’i besojmë edhe kënaqësisë që kanë ata të ndërmarin udhëtime, lehtëza, ngjitje a të pushojnë ndër malet tona, e të ndjekim shembullin e tyre në këtë pikë.

Parqgjykim: alpinistët janë të fortë e nuk pyesin për shi e erë, për borë e temperatura të ulta. Aspak e vërtetë: alpinistët janë njerëz, dhe si gjithë njerëzit e tjerë, janë të preکشëm nga elementët e natyrës. Ata mbërdhijnë, ftohen, kolliten, etj., dhe i përjetojnë elementët e natyrës, njëlloj si të gjithë njerëzit e tjerë. Ajo që i bën të ndryshëm nga të tjerët është se ata stërviten e kaliten që tu bëjnë ballë elementëve të natyrës. Duke u stërvitur, ata aftësohen t’ia dalin mbarë në kushte të motit të keq e të suksesojnë, por nuk mungojnë edhe raste kur ata dështojnë.

JO ALPINIZËM

Nëse, do të bënim një listë të atletëve ngjitësa, ata do i emërtonim në ngjitës malesh (alpinistë), ngjitës të faqeve shkëmbore (kacavarës), ngjitës të harcave (kacavarës), ngjitës të akujve (përsëri kacavarës) si dhe bjeshkatarë, të cilët shkojnë në mal për lehtizë, ose i ngjiten majës së malit në rrugë të thjeshta.

Tek ngjitesh në një mal, nga rrëza e tij e deri në majë, itinerari i zgjedhur të detyron të ecësh në të përpjeta e të tatëpjeta, si dhe të kacavaresh (të përdorësh njëherësh duart e këmbët për tu ngjitur a për të zbritur). Aty ku relievi është i vështirë për t'u kaluar, jo rrallë përdorim sigurimet me litar si dhe pajime të ndryshme që lehtësojnë kalimin e relievit apo edhe kalimin e një nate jashtë. Në këtë aventurë ngjitjeje, pjesa më emocionale është kacavarja. Dhe ndoshta, pasuria emocionale e kacavarjes gjatë sfidës për kalimin e relievit me pika, kapje e mbështetje të pakta, ka bërë që format e relievit kacavarës të imitohen dhe të sillen në palestra të mbyllura a të hapura në formën e mureve apo kullave.

Kacavarja

Tashmë, prej vitesh muret e ndërtuara, të cilat imitojnë relievin shkëmbor janë bërë pjesë e palestrave sportive. Këto mure mundësojnë të ashtuquajturën kacavarje artificiale (në kuptimin se nuk janë kacavarje në reliev natyror) ose kacavarje sportive.

Kacavarja e mureve artificiale ka një sërë përparësish, krahasuar me kacavarjen natyrore: me muret e ndërtuara, kacavarësi nuk ka se përse të shqetësohet rreth motit të keq (në ambjentet e mbyllura), akullit në shkëmb, errësirës së mbrëmjes apo temperaturave të ulta. Ato kanë gjithashtu përparësi lidhur me malet: aty vendosen litarë sigures pa vështirësi dhe itinerarët në to mund të përshtaten për nivele të ndryshme të aftësive kacavarëse. Thuhet, të njëjtat favore ka edhe kacavarja artificiale në muret, apo kullat e ndërtuara në vende të hapura.

Muret artificiale janë një mënyrë e mirë për fillestarët që të mësojnë, për kacavarësit e avancuar për të përsosur aftësitë e tyre, si dhe për alpinistët për stërvitje, apo edhe gara.

Muret e kacavarjes, fillimisht u ndërtuan (por edhe sot ndërtohen) me kompensatë. Kapjet e ngjashme me ato të shkëmbit punohen veçant dhe janë të mbërthyer në to. Ka mure për kacavarje, të cilat janë ndërtuar të duken e të ndjehen sikundër faqe të vërteta shkëmbore.

Ka mure të ndërtuar me plastikë, ka edhe të ndërtuara me beton dhe granit të thërmuar, të cilat duken sikundër shkëmb shtufor. Pikat e kapjes për duart e këmbët krijohen gjatë ndërtimit.

Kullat e kacavarjes janë një tjetër krijim artificial për kacavarësit: ato mbahen nga shtylla në çdo cep të tyre dhe e përdorin njerën anë për ulje (zbritje) me litar, e të tjerat për kacavarje. Blloqe druri janë fiksuar në sipërfaqen prej kompesate për të imituar buzë shkëmbore për duart e këmbët. Anët e ndryshme të kullës mendohen me konfiguracione, të cilat i përshtaten tre kategorive lidhur me aftësitë e kacavarësve: fillestarë, të mesëm e të avancuar.

Muret e kullat e kacavarjes janë kthyer edhe në arena sportive të kacavarjes, madje deri në organizim të kampionateve botërore.

Kacavjerja si proces, është diçka fizike dhe mendore. Kacavarsi, duhet të planifikojë çdo lëvizje dhe të jetë i pozicionuar në mur (kullë) sikundër duhet. Kjo, d.m.th. se i duhet të zgjidhë shumë situata problemore. Kacavarja është një mrekulli për të testuar vehten si dhe mundësi për të nxënë që të mbetesh i qetë. Nuk është sikundër sportet e tjera, sepse këtu nëse ju kapeni nga paniku, ju rrëzoheni. Porse, të rënët është pjesë e kacavarjes: kacavarësi duhet të stërvitet se si të manovrojë që kur të bjerë, të bjerë në mënyrë të tillë, që të dëmtohet sa më pak. Dhe për fatin e mirë, të rënët e kacavarësit nga muret artificiale të kacavarjes, është një problem shumë më i vogël se ai i rënies së alpinistit në mal, sepse ai në vendin ku bie ka mbushje sintetike të ngjashme me ato të atletëve të kërcimit së larti, apo kërcimit me shkop.

Kacavarja e mureve dhe kullave të ndërtuara, ka frymëzuar një sport krejt të ri: **kacavarjen sportive**. Sot, në vende të ndryshme, organizohen aktivitete garuese të llojeve të ndryshme në kacavarje por në fillimet e këtij sporti kacavarësit konkurronin në mure artificiale (si të ndërtuar në ambiente të mbyllura edhe në ato të ndërtuara në ambiente të hapura) në dy fusha:

- **shpejtësi**, në të cilën kacavarësi që arrin më shpejt në krye të «shkëmbit» shpallet fitues,
- **vështirësi**, në të cilën kacavarësi ballafaqohet me lëvizje gjithnjë e më të vështira, ndërkohë që përparon në lartësi. Kacavarësi, i cili arrin më lart shpallet fitues.

Veprimtari të tilla garuese, sot zhvillohen rëndom, madje edhe gjatë një fundjave, me vajza e djem, të cilët konkurojnë ndarazi. Në vende të ndryshme të botës, si rregull ka klasa stërvitore për amatorë të të gjitha moshave për të testuar aftësitë e tyre një ditë para fillimit të konkurimit.

Vlen të theksohet se në disa prej garuesve të kacavarjes sportive, por edhe në të rinj të zakonshëm, muri kacavarës është bërë pjesë e terrenit të tyre sportiv në oborin e shtëpisë, ose në dhomën e tepërt të shtëpisë.

Krahas kacavarjeve në mure, që imitojnë shkëmbin, organizohen edhe kacavarje në ambiente me akull artificial. Konstruksione druri, ose metalike, apo edhe objekte sociale si garazhe makinash etj., mundësohen që të vishen me akull, duke ngrirë ujin e spërkatur në to. Në formacionet e ngrira që krijohen, organizohen gara e kampionate sikundër edhe në imitacionet e shkëmbejve. Me raste, të tilla gara organizohen edhe në formacione natyrale ambjentesh të ngrira.

Një lloj tjetër kacavarje, që kryhet nga pak atletë, është *kacavarja e lirë*. Në këtë lloj kacavarje, atleti nuk përdor pajisje: ai ka një qeskë me magnezium, ku hera herës ngjyen gishtërinjtë dhe kacavaret në mure të vëtrteta shkëmbore, që me raste janë edhe mbi 100 metra. Në procesin e kacavarjes ai ka një përqëndrim të veçantë dhe besueshmëri të lartë në forcën fizike të krahëve të tij si dhe në aftësitë teknike kacavarëse. Kjo lloj kacavarje është me rrezik (nuk ka fare sigurim me litar dhe nuk përdoren pajisje alpinistike). Në këtë kategori, hyjnë edhe ata që kacavaren e ngjitjen në godinat më të larta në qytete të ndryshme të botës. Atletët, të cilët ndiejnë kënaqësi me këtë lloj aktiviteti të rrezikshëm, janë të paktë.

Kacavarja e lirë, dallohet nga *ngjitja solo* (vetanake). Në ngjitjen solo alpinisti ngjitet i vetëm, madje deri në majë të malit, por ai përdor litar dhe pajisje alpinistike për t'u siguruar.

Ai, vetësigurohet nga poshtë (e lidh litarin në plengën më të poshtme të segmentit që ngjitet) e ngjitet në një farë lartësie, si një filltar, e njëherësh ndjekës në detyrën e siguresit (nuk ja vlen ta spjegojmë zbatimin e këtij roli gjatë ngjitjes), ku bën rishtas sigurim (e lidh apo fikson litarin në lartësinë ku arrin). Pas kësaj, ai ulet poshtë dhe fillon (kryen) rolin e ndjekësit duke marrë të gjitha materialet e përdorura gjatë ngjitjes. Sigurisht, që kjo ngjitje në kohë zgjat ma shumë (alpinisti si të thuash e bën 'rrugën' dy herë: ngjitet 20 a më shumë metra duke bërë punën e filltarit, pastaj zbret deri në fund të segmentit të ngjitur dhe bën punën e ndjekësit).

Harcimi

Zhvillim të madh ka marrë kohët e fundit *harcim*, i që është kacavarja në një harc, (harc quhet një gur a një shkëmb i madh) i cili ndodhet në një vend të lehtë për tu arritur (vend i rafshtë ose jo por pranë rrugëve të komunikacionit). Grupe të rinjsh, të pajisur me këpucë të veçanta për kacavarje dhe qeska magneziumi, tentojnë t'i ngjiten harcit në drejtime nga ma të ndryshmet duke garuar ose jo, e duke demonstruar aftësi kacavarëse.

Teksa njëri kacavaret në bazën nga fillon ajo, vendoset një shtrojë e veçantë që mbron atletin nga dëmtimi në rast se ai bie, por njëherësh shoqëruesit e kacavarësit qëndrojnë në gatishmëri, që nëse ai bie, ata i vendosin duart në trupin e tij që ai të bjerë sa më vertikalisht. Sikundër kuptohet, në këtë kacavarje nuk përdoren pajisje teknike dhe harci si rregull nuk i kalon 5 metra lartësi. Kur organizohen garat e harcimit, shkëmbi (artificial) mundet të jetë edhe më i lartë, por në këtë rast shtresa mbrojtëse në bazën e nisjes është një shtrojë sfungjeri e trashë dhe e sigurtë për goditje të butë të kacavarësit në të.

Bjeshkimi

Bjeshkimi, është argëtimi a kënaqësia që të jep ngjitja në itinerarin e thjeshtë për në majë të malit, ose një lehtizë (shëtitje) nëpër shtigjet e një mali. Për realizimin e ngjitjes së malit, ose të lehtizës, bjeshkatarit nuk ka nevojë të përdorë pajisje teknike, të cilat i përdor për të kapërcyer terrenet e thyera një alpinist apo një kacavarës. Një shkop i zakonit apo një stekë skishë, janë si rregull të pranishëm në pajimet e bjeshkatarit, ku veç tij përfshihen edhe mjaft pajime të tjera, të cilat lidhen me kalimin e natës dhe të argëtimit në natyrë. Edhe një litar vlen që të merret e të përdoret në rastet, kur dikush ka nevojë për më shumë siguri në kalimin e terrenit të thyer ose kalimin e një lumi.

Bjeshkimi, është një mënyrë e këndëshme e kalimit të kohës së lirë në gjirin e natyrës nga kushdo, nga grupe me dy a më shumë të rinj e të reja, nga familjarë dhe fëmijët e tyre.

Ndër pajimet e një bjeshkatarit përmendim:

1. veshjen (nga koka tek këmbët) në vartësi të stinës ose të parashikimit të motit gjatë qëndrimit në bjeshkë (mal).
2. ushqime të ndryshme.
3. thes fjetje.
4. tendë.
5. pajimet e gatimit.
6. pajisjet për ngrënie

7. paketa e ndihmës së shpejtë.
8. ranc (çantë shpine) të madhësisë së përshtatëshe.
9. paketë higjienike, etj.

Rancat

Dashamirësit e natyrës, të cilët pushojnë në gjirin e saj duke udhëtuar, ose duke udhëtuar e fushuar, (kampuar) quhen ranca (njerës që mbartin në shpinë një çantë). Nëse do i krahasonim rancat me bjeshkatarët, do të thonim se, ndërsa bjeshkatarët i drejtohen vetëm malit, rancat i drejtohen jo vetëm malit por edhe kodrës, fushës, lumit, liqenit, etj. Në një farë mënyre rancat janë dashamirës të shlodhjes e argëtimit në natyrë pa dallime të relievit të natyrës.

Edhe kalimi kohës së lirë në natyrë si ranca, është një mënyrë e këndëshme e të qenit në gjirin e natyrës nga kushdo, nga grupe me dy a më shumë të rinj e të reja, nga familjarë dhe fëmijët e tyre.

Gara malore

Garat malore janë nga më të ndryshmet. Pjesmarrësit në këtë rast janë të veshur sikundër atletët në garat që zhvillohen në stadiume. Duke u ndalur vetëm në garat që zhvillohen më këmbë përmendim:

- a. Ngjitjet në majën e malit. Kjo si rregull kryhet duke kombinuar vrapimin me ecjen. Itinerari për në majë, zgjidhet i thjeshtë dhe përfundon në majë të malit ose me kthim poshtë tek pika ku fillon gara.
- b. *Qarkimi* në një zonë malore. Në këtë ‘maratonë’ para përcaktohet itinerari i lëvizjes përqark një masivi malor. Gara mund të jetë me vrap e disa orëshe, ose edhe me hap e disa ditore dhe kalon nëpër qendra të ndryshme të banuara.

S H T O J C A

11 Dhjetori

Sot, 11 Dhjetori njihet si Dita Ndërkombëtare e Malit. Kjo ditë, shfrytëzohet si një mundësi për të ndjesuar dhe edukuar në shoqëri kujdesin rreth rëndësisë së maleve në jetë, për të ndriçuar mundësitë dhe pengesat në zhvillimet ekonomike, e më gjërë, në zonat malore dhe për të ndërtuar partneritet, i cili do të sjellë ndryshime pozitive në komunitetet që jetojnë në malet dhe rafshnaltat e globit tonë.

Ishte, Organizata e Kombeve të Bashkuara ajo që caktoi 11 Dhjetorin, që nga viti 2003 e këndeje, si “Dita Ndërkombëtare e Malit.” Ky vendim rezultoi nga sukcesi i Vitit Ndërkombëtar të Maleve, i organizuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 2002, i cili rriti kujdesin global lidhur me rëndësinë e maleve, stimuloi krijimin e komiteteve kombëtare në 78 shtete dhe forcoi aleancat mes tyre nëpërmjet nxitjes e krijimit të Partneritet Ndërkombëtar për zhvillim të Qënësishëm në Rajonet Malore, i njohur ky si Partneriteti Malor. FAO ishte caktuar agjensi koordinuese udhëheqëse për Vitin Ndërkombëtar të Malit dhe ka mandatin për të udhëhequr përkujtimin e Ditës Ndërkombëtare të Malit.

Në botë, rreth një e katërta e relievit është e mbuluar nga malet dhe në to jeton rreth 10 përqind e popullatës. Në atdheun tonë dy të tretat e teritorit janë të mbuluara nga malet dhe disa prefektura janë tërësisht në territor malor.

11 Dhjetori, është ideuar si dita që njerzit të kujtojnë së bashku që jo vetëm pemët, uji, mineralet, e të tjera lëndë e gjallesa të prekëshme, janë burime jetese për banorët e vendeve malore, por që edhe soditja e jo shfrytëzimi i tyre, janë burime jetese sepse për shumë njerëz, turistë e dashamirës të natyrës, kalimi i kohës së lirë në mënyrë aktive në natyrë është burim frymëzimi, është çlodhje fizike dhe kënaqësi emocionale, është mundësi për të ripërtërirë forcat fizike e mendore për punë e jetë të shëndetëshme. Duke patur parasysh këtë fakt, është me vlerë të kujtojmë se argëtuesit në natyrë dhe banorët lokalë, duhet të kenë për çdo çast parasysh mënyrën se si sillen ndaj natyrës dhe si ta mbrojnë atë.

Për çdo vit Dita Ndërkombëtare e Malit përkujtohet me një temë të caktuar. Dashamirësit e natyrës, turistë e alpinistë, etj., e përkujtojmë këtë ditë në temën e turizmit dhe alpinizmit. Turizmi, industria ma e madhe botërore, është kthyer në një burim parësor të ardhurash për shumë vende malore. Ai sjell para të thata në afate kohore të shkurtëra, duke ndihmuar ndjeshëm banorët e vendeve malore të cilët, mesatërisht, në mbarë botën kanë të ardhura të ulta. Për këdo nga ne duhet të kihet parasysh fakti se në afate të largëta, një turizëm i pa kontrolluar, mundet të shkaktojë dëme të pariparueshme ndaj ambjentit.

Në botën e qytetëruar, shoqëritë janë përkrahëse të një turizmi e alpinizmi të kontrolluar. Dashamirësit e natyrës dhe ata që argëtohen në forma të ndryshme në natyrë, organizojnë argëtime duke lënë një ndikim negativ të pandjeshëm në mjedis dhe në kulturën lokale, kudo ku shkohet, dhe ndërkohë ndihmojnë për të krijuar vende a mundësi pune dhe të ardhura për komunitetet ku zhvillojmë veprimtaritë.

Mali i Dajtit në vjeshtë

Lehtizat në Malin e Dajtit janë gjithnjë shlodhëse, qetësuese dhe frymëzuese. Ky mal, *muri i blertë i Tiranës*, është gjithnjë i bukur. Ai ka bukuri vjeshtore në periudhën midis javës së fundit të muajit Tetor e (në mvartësi të kushteve të motit) deri në mesin e muajit Nëntor. Gjatë ditëve të kësaj periudhe në këtë mal, natyrën përreth e zbukurojnë ngjyrat vjeshtake të gjetheve të drurëve të ndryshëm. Bukuria e natyrës do të jetë epërore nëse kemi fatin që duke filluar nga mesi i muajit Tetor, për tre javë, moti të mbajë pa shira dhe pa erë të fortë. Veç kësaj, nëse në ato lartësi do të kemi netë me temperatura nën zero gradë Celcius, kjo do të bëjë që të theksohet bukuria e ngjyrave të gjetheve.

Bukurinë e vjeshtës në malin e Dajtit, njeriu mundet ta shijojë më shumë nëse kalon orët me lehtiza në natyrë pranë këtyre vendeve:

1. Tek zona ku del uji i burimeve të Shërmisë, në faqen e malit që sheh Tiranën. Ndërsa në stinën e verës, këtu gjeni freskinë më të mirë të malit, tani do të ndjeheni të 'zhytur' në pyllin e vjeshtës. Nëse nga rruga automobilistike filloni t'i ngjiteni të përpjetës majtas (kur jeni me fytyrë nga mali) dhe të arrini deri tek kështjella prehistorike, të cilës i kanë mbetur vetëm rënojat e murit rrethues me gurë të pa lidhur, ju do i jetoni dhe shijoni edhe më fort ngjyrat e pyllit të vjeshtës në këtë zonë.
2. Tek Fusha e Dajtit. Tarraca apo Fusha e Dajtit u krijon mundësi të hapësirave për lojë dhe lehtizë, si dhe për të soditur pamjet tërheqëse të natyrës, qytetit dhe rrethinave të Tiranës, e madje, nën një qiell të pastër, edhe pamjen e largët të bregdetit rreth qytetit të Durrësit, si dhe shumë më shumë.
3. Nëpër Shtegun e Tërthortë. Në zonën e Fushës së Dajtit (pranë teleferikut) nëse niseni nga rruga e makinës dhe i ngjiteni malit drejt e përpjetë pa u ndalur për rreth 5 deri 10 minuta (kjo varet nga pika e nisjes) ju do të arrini në një lehtizore të 'shtruar', (shtegu i tërthortë) e cila dikur përdorej nga udhëheqësit e sistemit punist për lehtizë. Tek të arrini

- këtu vini (ose mbani mend) dy tre shënja orjentuese në mënyrë që të dini vendin se ku do të filloni zbritjen pasi të ktheheni nga lehtëza. U këshillohet që të lëvizni majtas; shtegu i shkon malit tërthor, majtas e djathtas. Lëvizja nga ana veriore (majtas) u nxjerr në grykën e Tujanit, e prej aty duke ndjekur ‘rrugën’ ju mundet të shkoni edhe ca më tej, përtej tunelit, për të soditur format e guximëshme e të thikta të relievit të malit nga kjo anë. Bëni kujdes, që kur të mbarojë rruga e ‘shtruar’ të mbani shtegun e sipërm!
4. Kreshta e Dajtit. Nëse dëshironi të sodisni vjeshtën dhe natyrën përreth nga një lartësi mbizotëruese e malit, u rekomandohet të ndërmerrni udhëtimin e Kreshtës së Dajtit Ky udhëtim u mundëson jo vetëm që të jetoni për disa orë me pyllin dhe malin në vjeshtë, por njëherësh u jep rast që të soditni pamjet magjepëse që u hapen në të dy anët e kreshtës, duke kundruar kështu një teritor të gjërë të Ultësirës Perëndimore dhe Maleve Qëndrore të Shqipërisë. Për të realizuar kalimin e Kreshtës së Dajtit u duhet që me mjet të shkoni deri në guroren e Qafë Priskës dhe prej aty të filloni ngjitjen, e cila në 45 minutat e para është e lodhëshme (pjerrësia mesatare është 30 gradë). Marshimin e përfundoni në Majën e Dajtit (1613m.) dhe prej aty uluni drejt e në Fushën (taracën) e Dajtit.
 5. Maja e Tujanit dhe Maja e Dajtit. Nga Fusha e Dajtit, mundet që të ngjiteni drejt e tek Qafa e Qershisë. Qafa është një vend i këndëshëm midis dy majave për të kaluar kohën, dhe nëse dëshironi të ngjiteni më tej, prej aty mundet të vazhdoni për në Majën e Tujanit, (drejtimi majtas) ose të Dajtit (drejtimi djathtas).

Duhet të keni parasysh se kalimi i Kreshtës së Dajtit, në veçanti, apo ngjitjet në çdonjërin nga majat, kërkon që të ndërmerren nga ju, vetëm nëse jeni ushtruar fizikisht në mënyrë të rregullt. Në të kundërt, lodhja apo dhimbja e këmbëve (mbas 24 orësh) që do u shkaktojë kjo veprimtari fizike do u venisë bukurinë e vjeshtës në mal.

Dhe mos harroni: nuk është vetëm mali i Dajtit me bukuri të veçanta ngjyrash në vjeshtë, por edhe çdo mal tjetër aty pranë, apo edhe larg, vendbanimit tuaj.

Të kujdesurit për natyrën

Bukuria e pamjeve të natyrës shpesh është aq joshëse sa njerzit “fusin duart në të” në mënyrë të gabuar dhe ndikojnë në çbërjen e saj. Pasoja e parë: ambjentit të prekur nga njeriu i bie natyrshmëria. Në përgjithësi ne, banorë të natyrës dhe dashamirës e vizitorë të saj po e konsumojmë atë, hera-herës në një shkallë alarmuese duke e përdorur dhe duke e ndryshuar atë sipas mënyrës sonë.

Malet dhe gjithshka që formon natyrën mbi tokë nuk egzistojnë për zbavitjen tonë. Ato as nuk na detyrohen për gjë, e as nuk kërkojnë gjë prej nesh. Ndërkohë, që ne si soditës të natyrës udhëtojmë nëpër të, për këtë privilegj, detyrimi ynë minimal është që ta lëmë atë n’atë gjendje që e gjejmë, pa shenja të qënies sonë atje. Ne duhet t’i studjojmë vendet ku kalojmë dhe të bëhemi të ndjeshëm ndaj cënueshmërisë së tyre. Duke patur parasysh lëndueshmërinë e natyrës duhet të kampojmë, ngjitemi a ndërmarrim lehtëza në të në mënyra të cilat e minimizojnë ndikimin tonë mbi të.

Privilegjet e kënaqësive në natyrë sjellin tek ne përgjegjësinë për të ndihmuar që të ruajmë këtë ambjent që e dashurojmë. Në mungesë të legjislacioneve të nevojshme, ne që jemi më të dhënë ndaj natyrës, duhet të udhëhiqemi nga motivi: *“T’i kënaqemi natyrës dhe të largohemi nga ajo pa lënë gjurmë të qënies sonë atje.”*

Sot faktet e jetesës gjatë ngjitjeve e lehtëzave si dhe qëndrimit ndër male a në natyrë në shumë vende të botës së qytetëruar përfshijnë sisteme lejimi të cilat kufizojnë hyrjen në zona të thella, me pastbloqe e ndalime, apo kufizime për veprimtari të caktuara, projekte restauruese mjedisore, kujdesje legjislative dhe rregulla në rast ndeshje të grupeve të interesave që konkurojnë. Le t' i kemi parasysh gjithnjë këto realitete, e të kontribuojmë pozitivisht me dijet tona lidhur me këto tema!

Ndërkohë që ne nuk kemi një legjislacion të plotë që të kujdeset për natyrën, na duhet jo vetëm që të shkelim me kujdes ndër male apo natyrë, por është njëherësh koha të ngremë zërin për mbështetje të mbrojtjes e ruajtjes së natyrës dhe përdorimin e kujdesëshëm të hapësirave të virgjëra. Si ngjitës malesh, ne duhet të jemi mbrojtës veprues të natyrës, nëse duam që edhe pasardhësit tanë të jenë në gjendje t' i kënaqen asaj që ne sot e mendojmë se na është e dhënë.

Batina historike në ngjitjen e maleve

Vite më parë në një akullnajë të Alpeve u zbulua kufoma e një njeriu që akulli e kishte ruajtur mirë. Njeriu kufomë u quajt Otzi. Shkenca tregoi se Otzi është ngjitur 5,300 vjet ma parë të paktën deri në lartësinë 3,000 metra mbi nivelin e detit, lartësi në të cilën u gjet kufoma e tij. Otzi përfaqëson, veç të tjerash, dokumentin e parë të njeriut të ngjitur në lartësi të maleve.

Deri më sot, ngjitja e parë e dokumentuar, pas Krishtit, është ngjitja më vitin 121 në malin Etna (3,350 m) nga perandori Hadrian. Qëllimi i ngjitjes së tij ishte që të shihte lindjen e diellit.

Pjetri i tretë i Aragonës u ngjit në majën Canigou të Pirenejve në tremujorin e fundit të shekullit të 13-të.

Ngjitja e parë në majën Popocatepetl (5,426 m) në Meksikë u raportua më 1289 nga anëtarët e tribusë vendase Tecanuapas.

Me urdhër të Karlit të Tetë të Francës më 1492 u ngjit në Alpe maja Mont Aiguille. Humanistët e shekullit të 16-të përshtatën një qëndrim të ri ndaj maleve, por gjendja e turbullt e Evropës prishi me rrënjë shkollën e sapolindur të ngjitjeve malore të Zyrihut.

Leonardo da Vinci ka ngjitur një zonë bore të malit në Val Sesia dhe kreu vëzhgime shkencore.

Më 1642 Darby Field kreu ngjitjen e parë të rregjistruar të Mount Washington, më vonë e njohur si Agiocochook, në shtetin New Hampshire në Sh.B.A.

Konrad Gesner dhe Josias Simler nga Zyrihu vizituan dhe përshkruan malet (Alpet) teksa kryen ngjitje të rregullta. Në këtë kohë nga vendasit (banorët e Alpeve) përdorëshin alpenshtokët dhe litarët nga vendasit. Nuk ka rekorde për ndërmarrje ngjitjesh malore në shekullin e 17-të.

Vizita e Richard Pococke dhe Ëilliam Windham në Chamonix (Shamoni) konsiderohet historike ngase nxiti prirjen për të vizituar akullnajat.

Më 1744 u ngjit maja Titus (Alpe), e njohur kjo ngjitje si ngjitja e parë e një mali të mbuluar me borë.

Nga të dhënat arshivore, rezulton se majën e Jezerës, pullazin e Bjeshkëve të Namuna, e kanë ngjitur më 1765 për qëllime topografike një truproje e ushtrisë turke e Garnizonit të Shkodrës, e shoqëruar nga të rinj të bajrakut të Dukagjinit e Thethit.

Ngjiteti i maleve Norvegjezi Jens Esmark ishte i pari që u ngjit në Snohetta më 1798, pjesë kjo e kreshtës Dovrefjell në Norvegjinë Jugore. Në të njëjtin vit ai udhëhoqi ekspeditën e parë në Bitihorn, një mal i vogël që ngrihet në pjesën më jugore të Jotunheimen, Norvegji.

Në Alpe në vitin 1800 u ngjit maja Grossglockner, më 1804 maja Ortler, më 1811 maja Jungfrau, më 1812 maja Finsteraarhorn dhe më 1813 maja Breithorn. Pas kësaj turistat malorë shfaqën tendencën e ngjitjeve e për pasojë u krijuan shoqëritë e shoqëruesve Alpinë (guidave).

Maja Citlaltepel (5,720 m) në Meksikë u ngjit për të parën herë më 1848 nga F. Maynard dhe G. Reynolds.

Data e lindjes së Alpinizmit si sport është pranuar dita e ngjitjes së parë në Mont Blanc, kurse ngjitja **sistematike** malore, si një sport, është datuar nga ngjitja në Matterhorn më 1854 nga Sir Alfred Wills. Ngjitja e parë në Monte Rosa u krye më 1885.

Klubi Alpin i parë u krijua në Londër më 1857. Shumë shpejt Klubet alpine u imituan në më të shumtat e vendeve të Evropës (Perëndimore). Ngjitja në Matterhorn më 1865 nga Edward Whymper shënon mbylljen e periudhës kryesore të pushtimeve Alpine, të njohur edhe si “Mosha e artë e alpinizmit”, gjatë të cilës u shpik dhe u “përsos” arti i kacavarjes/ngjitjes; ndërkohë në këtë periudhë u formuan dhe u fiksuan traditat e grupimeve të udhërefyësve profesionistë

Duke folur për zona të tjera malore themi se eksplorimi i Pirenejve ishte i njëkohshëm me atë të Alpeve. Më pas vemendja koloj në malet Kaukaze. Ato i synoi fillimisht D.W. Freshfield; ngjitetit eksploruës u dukën më 1868 dhe më e shumta e majave më të rëndësishme u ngjitën deri më 1888.

Edelweiss Club Salzburg u themelua më 1881 në Salzburg. Nga ky klub dolën më vonë tre anëtarë të cilët ngjitën dy tetëmijëmetroshtë: Broad Peak më 1957 dhe Dhaulagiri më 1960.

Ngjitet të stërvitur e kthyen vemendjen nga malet e Amerikës Veriore më 1888, atëherë kur i Përnderëshmi E.S. Green kreu një ekspeditë në Sekirk Mountains. Që nga ajo kohë eksplorimi lëvizti me shpejtësi dhe shumë ngjitet Amerikanë e Anglezë kanë vëzhguar më të shumtat e majave ma të larta: Pikes Peak (4,302 m) u ngjit nga grupi i E. James më 1882; Mt. Saint Elias (5732 m) u ngjit nga Duka i Abruzzi-t me shokë më 1897. Eksplorimi i Andeve filloi në periudhën 1879-1880 në kohën kur Whymper ngjiti majën Chimborazo si dhe eksploroj malet e Ekuadorit. Kordillera midis Kilit e Argjentinës u vizitua nga Dr. Gussfeldt më 1883, i cili ngjiti edhe majën Maipo (5264 m) si dhe tentoi majën Aconcagua. Kjo majë u ngjit për të parën herë nga ekspedita e Fitzgeralds më 1897.

Andet Boliviane u eksploruan së pari nga Sir William Martin Conway më 1898. Ekspeditat Kiliane e Argjentinase treguan strukturën e Colldiliera-s Jugore gjatë viteve 1885-1898. Conway vizitoi edhe malet e Tierra del Fuego.

Alpet Jugore të Zelandës së Re u vizituan më 1882 nga i Përnderëshmi W.S.Green, dhe pas kësaj shumë shpejt u krijua një klub alpin Neo Zelandez. Kjo mundësoi eksplorimin e matejshëm të kreshtës malore. Më 1895 Major Edward Arthur Fitzgerakld ndërmori një udhëtim të

rëndësishim në këtë kreshtë. Porse Tom Fyfe me shokë ngjiti majën Aoraki apo Mount Cook në ditën e Krishtlindjes më 1894 duke i hequr nga dora Fitzgeraldit ngjitjen e parë. Ky i fundit po udhëtonte me udhërefyeesin Zvicerian Mathias Zurbriggen për të realizuar ngjitjen e parë të majës. Kështu, i lënduar në sedër që humbi mundësinë e ngjitesit të parë të majës, nuk pranoi të ngjitet në majën më të lartë dhe u përqëndrua në maja të tjera të kreshtës. Më vonë gjatë udhëtimeve Zurbriggen u ngjit i vetëm në majë nëpër një kreshtë e cila sot mban emrin e tij.

Malet e para të zonave Artike të cilat u eksploruan ishin ato Spitsbergen nga ekspedita e organizuar nga Sir W.M. Conway në vitet 1896 dhe 1897.

Ndër malet e larta të Afrikës, Kilimanjaro u ngjit më 1889 nga Dr. Hans Meyer, Mali Kenia u ngjit më 1899 nga Halford John Mackinder dhe maja Ruënzori u ngjit nga H.J.Moore më 1900.

Malet Aziatike u shqyrtuan fillimisht nën urdhërat e Perandorisë Britanike. Më 1893 Sir William Martin Conëay eksploroj Karakoromet dhe ngjiti një majë 7,000 metra të lartë. Më 1895 Albert F. Mummery vdiq tek tentoi të ngjisë Nanga Parbat-in. Më 1899 D.W.Freshfield ndërmori një ekspeditë në rajonet e mbuluar me borë të Sikkim-it. Më 1899, 1903, 1906, dhe 1908 Mrs. Fannie Bullock Wolkman bëri ngjitje në Himalajat, përfshirë një nga majat e Nun Kun-it me lartësi 7,102 metra. Disa persona nga Gurkha u stërvitën si ekspertë të ngjitjes së maleve nga Majori i Nderuari C.G. Bruce dhe ata kryen mjaft në drejtim të eksplorimit të maleve.

Më 1902 Ekspedita Eckenstein-Crowley, e udhëhequr nga alpinisti Oscar Eckenstein dhe mjeku oculist Aleister Croëley kreu të parën tentativë për të ngjitur majën Chogori (K2). Ata arritën lartësinë 6,700 metra dhe u kthyen për arsye të motit të lig si dhe për kokëçarje të ndryshme.

Më 1905 Aleister Crowley udhëhoqi ekspeditën e parë në Kachenjunga, mali i tretë në botë për nga lartësia. Katër pjestarë të grupit gjetën vdekjen nga një orte. Të tjerët pretenduan se arritën lartësinë 6,500 metra para se të ktheheshin, kurse Crowley në autobiografinë e tij pretendon se arrit lartësinë 7,600 metra.

Viti 1950 pa ngjitjen e tetëmijëmetroshtit të parë, Annapurna-s, nga francezët Maurice Herzog dhe Louis Lachenal. Maja më e lartë e planetit, mali Everest (8,848 m) u ngjit për të parën herë nga Sir Edmund Hillary dhe Tenzing Norgay nga ana jugore (Nepal) e malit. Nuk kaloi shumë dhe Hermann Buhl realizoi ngjitjen e parë në Nanga Parbat (8,125 m) e cila në rrethana të çuditëshme përfundoi me një ngjitje të vetmuar (solo). Është i pari e i vetmi tetëmijëmetrosht i ngjitur solo që në ngjitjen e parë! K2 (8,611 m), maja e dytë në botë për nga lartësia u ngjit më 1954 nga një ekspeditë Italiane. Maja ma e ulët e tetëmijëmetroshtëve, 8,013 metrosht Shishapagma është i fundit që u ngjit nga njeriu. Kjo ndodhi më 1964 ngase Kina komuniste nuk lejonte ngjitës të huaj. Suksesi u arrit nga alpinistët Kinezë.

Fundi i Librit